

Raporti për zonën e “Astirit”

Përmbajtja:

- 1. Hyrje**
- 2. Vendimmarrja për miratimin e projektit “Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi – pallati me shigjeta – rrethrotullimi Shqiponja”**
- 3. Procesi i ndjekur nga ana e ARRSH-së.**
- 4. Procedurat e shpronësimit.**
- 5. Veprimtaria e ALUIZNI-t.**
- 6. Bashkëpunimi i Bashkisë Tiranë në proces.**
- 7. Roli i IKMT-së dhe IMT në Bashkinë Tiranë.**
- 8. Transparenca e organeve publike të përfshira në këtë proces.**
- 9. Konkluzione përfundimtare.**
- 10. Rekomandime**

1.Hyrje

Institucioni i Avokatit të Popullit ka në fokusin e veprimtarisë së tij promovimin, parandalimin e shkeljes dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, përfshirë këtu të drejtën për mirëqeverisje, të drejtën e pronës, si edhe të drejtën për strehim të përshtatshëm. Këto kompetenca të institucionit janë parashikuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe në Ligjin nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar. Në ushtrim të kompetencave dhe detyrave të tij funksionale, institucioni i Avokatit të Popullit ka qenë mjaft aktiv dhe i fokusuar në trajtimin dhe shqyrtimin në themel të disa prej problematikave kyçe, të ndjeshme dhe delikate për komunitete të gjera individësh, siç edhe komunitetet e banorëve që po preken në vijimësi në zonat që përfshihen në gjurmën e ndërtimit të projekteve (Lot-eve), të Unazës së Madhe të Qytetit të Tiranës.

E drejta e pronës është një e drejtë themelore shumë e rëndësishme në një shtet demokratik. Mosrespektimi i së drejtës së pronësisë si një ndër të drejtat më themelore të njeriut vazhdon ende të përbëjë një fenomen shqetësues për realitetin shqiptar. Respektimi dhe mbrojtja e së drejtës së pronës ka qenë në fokus të një numri të konsiderueshëm ankesash të paraqitura pranë institucionit të Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit thekson se e drejta e pronës duhet të mbrohet e garantohet jo vetëm në tekstet e ligjeve dhe akteve nënligjore por duhet të jetë në themel të punës së çdo institucioni të administratës shtetërore për të garantuar zbatimin efektiv të kësaj të drejte.

Në këtë drejtim, Avokati i Popullit është vënë në dijeni dhe ka filluar trajtimin e problematikave që lidhen me zbatimin e projektit “Rehabilitimi i segmentit rrugor “Mbikalimi i pallatit me shigjeta, rrethrotullimi “Shqiponja” pikërisht duke u bazuar në petitionin e paraqitur nga banorët e segmentit të zonës së Astirit, nga ankesat individuale të paraqitura në institucionin tone, ankesat e administruara në terren gjatë verifikimeve dhe inspektimeve të ndërmarra nga ekspertë të institucionit, si edhe raportimet në median e shkruar apo edhe vizive. Procedurat e hetimit dhe shqyrtimit nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit janë fokusuar kryesisht në legalizimin e objekteve të vetëdeklaruar nga ana e subjekteve të ndryshme, prishjen e ndërtimeve ekzistuese me destinacion banimi ose tregtar, si edhe kompesimin për efekt shpronësimi të subjekteve, të cilët kanë në pronësi apo posedim pasuri të paluajtshme në zonën e Astirit, Tiranë.

Ndërhyrjet për prishjen e ndërtimeve/objekteve, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor të sipërcituar filluan menjëherë pas njoftimeve të papritura në median vizive, pas të cilave u prishën disa banesa dhe disa vepra publike, ndërkohë që pritet që, ndërhyrjet të vazhdojnë për të prishur një numër të konsiderueshëm banesash duke lënë të pastrehë shumë familje, që prej vitesh jetojnë në këtë zonë të qytetit të Tiranës.

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit janë paraqitur 16 ankesa individuale, si dhe është filluar me iniciativë një rast, që lidhet me këtë problematikë. Ndër ankesat e paraqitura veçojmë një petition të dërguar në datën 13.11.2018, të nënshkruar nga 427 banorë të zonës së Astirit, banesat e të cilëve preken nga zbatimi i projektit, “Rehabilitimi i segmentit rrugor “Mbikalimi i pallatit me shigjeta, rrethrotullimi “Shqiponja”, si edhe “Letra e Hapur”, drejtuar Kryetarit të Bashkisë Tiranë, për të cilën hartuesit kanë vënë në dijeni edhe Avokatin e Popullit.

Institucioni i Avokatit të Popullit në ushtrim të mandatit të tij kushtetues, ka iniciuar kryesisht shqyrtimin e problematikës së prishjes, të ndërtimeve/objekteve në zonën e Astirit, Tiranë, prej Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT). Inicimi i kësaj çështjeje kryesisht ka filluar në bazë të informacioneve të bëra publike në median vizive, menjëherë pas deklaratave publike të përfaqësuesve të disa prej organeve të administratës publike, të përfshira në këtë proces, si ARRSH, IKMT, ALUIZNI dhe Bashkia Tiranë, për prishjen e rreth 317 objekteve që ndodheshin në gjurmën e projektit që do të zbatohet.

I gjithë ky proces i është nënshtruar një monitorimi të vazhdueshëm në vend, nga ana e Avokatit të Popullit, për çdo njoftim apo çdo ngjarje që lidhet me veprimtarinë e organeve publike, si dhe të protestave të shpeshta, të banorëve të zonës së Astirit.

Këto problematika vijojnë të jenë të pranishme edhe në zona dhe projekte të tjera, në qytetin e Tiranës.

Ky raport nuk duhet konsideruar si një fokusim fragmentar i problematikës që lidhet vetëm me projektin që po zbatohet për ndërtimin e Unazës së Madhe të Tiranës, në zonën e Astirit, por si një vazhdim dhe analizë kritike e respektimit të të drejtave dhe lirive të ligjshme të njeriut në proceset e realizimit të veprave publike nga ana e institucioneve, apo organeve të ndryshme shtetërore.

Raporti analizon elementët kryesorë të konstatuara rreth këtyre problemeve, duke u fokusuar fillimisht në procesin e vendimmarrjes për miratimin e projektit që po zbatohet, veprimtarinë e ALUIZNI-t, dhe vijon me procesin e ndjekur nga ARRSh, procedurat e shpronësimit, bashkëpunimin e rolin e Bashkisë Tiranë në këtë proces, si edhe rolin e IKMT dhe IMT të Bashkisë Tiranë, apo subjekteve të treta që kanë kryer veprime për prishjen e banesave, ose të veprave publike.

Raporti i hartuar nga Avokati i Popullit pasi konstaton problematikat konkrete, del me disa konkluzione dhe rekomandime të rëndësishme me qëllim adresimin e tyre tek institucionet e përfshira në këtë proces. *Problematikat e trajtuara në këtë raport, mbulojnë periudhën kohore nga fundi i muajit Tetor 2018, deri në muajin Qershor 2019.*

Më poshtë do të sqarojmë hollësisht gjithashtu edhe pretendimet e banorëve të kësaj zone, konstatimet e arritura si rezultat i hetimit administrativ nga institucioni Avokatit të Popullit, mbi rolin e organeve përgjegjëse të administratës publike, hapat e ndërmarra prej tyre për zgjidhjen e kësaj çështjeje, procedura e ndjekur për shpronësimin e banorëve, si dhe rekomandimet përkatëse mbi këtë rast.

2. Vendimmarrja për miratimin e projektit “Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi – pallati me shigjeta – rrethrrrotullimi Shqiponja”.

Konkretisht, që nga fundi i muajit Tetor 2018, institucioni i Avokatit të Popullit ka filluar monitorimin e situatës së krijuar në zonën e ashtëquajtur të “Astirit”, në Tiranë. Nga kontaktet e marra me banorë të kësaj zone ngrihet pretendimi se, projekti që po zbatohet në këtë zonë është hartuar dhe miratuar pa një proces real konsultimi dhe informimi publik, sikundër pretendohet

prej tyre edhe për ndërhyrje të shumta në projektin paraprak. Sipas tyre, këto ndërhyrje kishin si qëllim favorizimin e disa subjekteve, apo personave të veçantë, me qëllim zhvillimin e zonës në afërsi të projektit me ndërtime të larta.

Ajo që është evidentuar gjatë kësaj periudhe, para se të fillonim shqyrtimin me iniciativë të problematikave në tërësi, apo edhe të ankesave individuale që na janë paraqitur nga ankues apo grup ankuesish të ndryshëm, është fakti se nuk ka patur një informacion apo njoftim zyrtar të saktë mbi projektin që po zbatohet në këtë zonë, vendimin me të cilin ai është finalizuar, koston e tij totale, si edhe koston e planifikuar për shpronësimin e banorëve në bazë të kuadrit ligjor që rregullon procedurat e shpronësimit. Ky ka qënë dështimi i parë i organeve të administratës shtetërore në këtë problematikë komplekse.

- i- Duke u fokusuar tek projekti zhvillimor i miratuar për kryerjen e punimeve që do të kryheshin në këtë zonë, dhe në kuadër të hetimit të kësaj çështjeje nga ana jonë, i jemi drejtuar me shkresën tonë nr. K3/K45-9 datë 16.11.2018, **Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT)**, duke kërkuar dhënien e shpjegimeve lidhur me pretendimet dhe shqetësimet e banorëve të zonës.

Bazuar në përgjigjen e dhënë nga ana e kësaj Agjencie me shkresën nr.1494/1 datë 22.11.2018, ku sqarohet pjesa e kompetencës dhe përgjegjësisë institucionale për çështjet dhe problematikat që lidhen me zhvillimin e territorit, i jemi drejtuar në vazhdim me një kërkesë për informacion, me anë të shkresës sonë nr.K3/K45-14 datë 18.12.2018, **Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (AZHT)**. Nëpërmjet kësaj shkrese është kërkuar informacioni nëse është paraqitur pranë AZHT, në përputhje me detyrimet e parashikuara në Ligjin 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, projekti për punimet e zgjerimit të segmentit të Unazës së Re të Tiranës, në zonën e Astirit dhe cilat janë mendimet e dhëna nga ana e AZHT lidhur me këtë projekt, nëse ai është paraqitur për shqyrtim apo mendim pranë Agjencisë së Zhvillimit të Territorit.¹

Institucionit në fjalë i është kërkuar gjithashtu edhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me këtë çështje, duke synuar sqarimin sa më të shpejtë dhe përfundimtar të pretendimeve dhe shqetësimeve të ngritura prej ditësh nga komuniteti i banorëve që do të preken nga zbatimi i këtij projekti.

Në shkresën nr. 3116/1 prot, datë 26.12.2018,² nga ana e AZHT-së sqarohet ndër të tjera se, ***në mbledhjen e datës 20.11.2018, Këshilli Kombëtar i Territorit miratoi Vendimin nr.01, “Për***

¹ Informacioni kërkuar ka të bëjë konkretisht me këto pyetje;

a) nëse është paraqitur pranë AZHT, në përputhje me kompetencat e parashikuara në Ligjin 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, projekti për punimet e zgjerimit të segmentit të Unazës së Re të Tiranës, në zonën e Astirit

b) cilat janë mendimet e dhëna nga ana e AZHT lidhur me këtë projekt, nëse ai është paraqitur për shqyrtim apo mendim pranë Agjencisë së Zhvillimit të Territorit;

c) si dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me këtë çështje, duke synuar në sqarimin sa më të shpejtë dhe përfundimtar të pretendimeve dhe shqetësimeve të ngritura prej ditësh nga komuniteti i banorëve që do të preken nga zbatimi i këtij projekti.

² Në shkresën nr. 3116/1 prot, datë 26.12.2018, të AZHT-së, thuhet se:

miratimin e lejes së zhvillimit për objektin: “Rehabilitimi i segmentit rrugor “Mbikalimi i pallatit me shigjeta, rrethrotullimi “Shqiponja”, Bashkia Tiranë”.

Një konstatim që bie në sy në përmbajtjen e kësaj shkrese të AZHT-së, është fakti se, institucioneve si, Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) Tiranë, ZVRPP Tiranë, Agjencisë së Trajtimit të Pronave, si dhe Bashkisë Tiranë, AZHT-ja i është drejtuar me shkresa për informacione, dhe elementë dakordësie procedurale, të përcaktuara në procedurat e miratimit të projekt vendimeve specifike nga ana e KKT-së, vetëm 1 ditë para se të merrej Vendimi nr.1, datë 20.11.2018 i KKT-së, “Për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin: “Rehabilitimi i segmentit rrugor “Mbikalimi i pallatit me shigjeta, rrethrotullimi “Shqiponja”, Bashkia Tiranë” dhe kohë pasi kishin nisur veprimet për realizimin e këtij projekti të pamiratur ende.

Sjellim në vëmendje faktin se, në përputhje me pikën 4, të nenit 10/1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, afati kohor për marrjen e vendimit, është brenda 20 ditëve pune nga marrja në dorëzim e kërkesës për leje zhvillimi, së bashku me dokumentacionin e plotë shoqëruar të saj. Për më tepër, në pikat 6 dhe 7, të po këtij neni, përcaktohet edhe procedura që ndiqet nga autoriteti vendor përgjegjës ose KKT-ja, në rastet kur në lidhje me kërkesën për leje duhet të shprehen paraprakisht edhe autoritete të tjera publike. Duke iu referuar këtyre procedurave dhe afateve ligjore, theksojmë se pavarësisht kërkesave tona drejtuar AZHT-së apo edhe ARRSH-së, për të sqaruar procedurat dhe afatet e ndjekura nga ana e ARRSH-së, për miratimin e kërkesave për vendimmarrjen e nevojshme nga ana e KKT-së, për lejimin e punimeve për objektin: “Rehabilitimi i segmentit rrugor “Mbikalimi i pallatit me shigjeta, rrethrotullimi “Shqiponja”, Bashkia Tiranë”, nuk na është dhënë informacioni i plotë i kërkuar. Më konkretisht, nuk na është dhënë si informacion data, në të cilën ARRSH-ja ka dorëzuar në KKT, kërkesën për leje zhvillimi, së bashku me dokumentacionin e plotë shoqëruar të saj. I vetmi informacion që jepet për këtë gjë është një paragraf, në shkresën nr.3116/1 datë 26.12.2018, të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, drejtuar Avokatit të Popullit, ku thuhet shprehimisht se: “...sqarojmë se zhvilluesi, Autoriteti Rrugor Shqiptar ka aplikuar në sistemin e-Leje, për pajisje me leje

“Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitutional dhe në zbatim të pikës 12, të Urdhërit të Kryeministrit nr.143 datë 3.11.2015 “Për ngritjen dhe funksionimin e strukturave përgjegjëse për bashkërendimin e punës me Agjencinë e Zhvillimit të Territorit (AZHT)”, AZHT-ja ju drejtua në rrugë shkresore institucioneve të poshtëshënuara:

- *Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) Tiranë, (Shkresa nr.2832/4 prot, datë 19.11.2018), me anë të së cilës kërkohet informacion i detajuar mbi të gjitha pasuritë/pronat që preken nga ky projekt, të cilat janë trajtuar, apo janë në proces nga ALUIZNI;*
- *ZVRPP Tiranë (shkresa me nr.2832/1 prot, datë 19.11.2018), me anë të së cilës kërkohet informacion i detajuar mbi të gjitha pasuritë/pronat që preken nga ky projekt, të cilat janë regjistruar pranë ZVRPP tiranë dhe statusi juridik, shoqëruar nga kartelat dhe hartat treguese, në lidhje me pasuritë në fjalë;*
- *Agjencisë së Trajtimit të Pronave, (shkresa me nr.2832/1 prot, datë 19.11.2018), me anë të së cilës kërkohet informacion i detajuar mbi të gjitha pasuritë/pronat që preken nga ky projekt, të cilat janë trajtuar, apo janë në proces nga ATP dhe kopje të akteve përkatëse (nëse ka), të lëshuara nga ky institucion, në lidhje me pasuritë në fjalë;*
- *Bashkisë Tiranë (shkresa me nr.2832/2 prot, datë 19.11.2018), me anë të së cilës kërkohet pëlqimi/dakortësia e Bashkisë për këtë projekt propozim; informacion i detajuar mbi të gjitha pasuritë/pronat që preken nga ky projekt, të cilat janë në pronësi/administrim të Bashkisë Tiranë dhe kopje të dokumentacionit përkatës ligjor që disponon ky institucion në lidhje me pasuritë në fjalë”.*

Zhvillimi, për: “Rehabilitimi i segmentit rrugor “Mbikalimi i pallatit me shigjeta, rrethrotullimi “Shqiponja”, Bashkia Tiranë””.

Pa paragjykuar këtë fakt, dhe pavarësisht kohës shumë të shkurtër (24 orë) në dispozicion, prezumohet se KKT-ja ka patur të gjithë informacionin e nevojshëm mbështetës, për marrjen e Vendimit nr.1 datë 20.11.2018.

Miratimi i lejes së zhvillimit, përkatësisht me **Vendimin nr.1 datë 20.11.2018, të Këshillit Kombëtar i Territorit,**³ **“Për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin: “Rehabilitimi i segmentit rrugor “Mbikalimi i pallatit me shigjeta, rrethrotullimi “Shqiponja”, Bashkia Tiranë”,** është një moment shumë i rëndësishëm në trajtimin e kësaj problematike, pasi në përputhje me legjislacionin në fuqi, dokumenti i lejes së zhvillimit është **parakusht** dhe shërben si bazë për pajisjen me lejen e ndërtimit. Kjo e fundit, pra leja e ndërtimit është akti administrativ që i mundëson subjektit zhvillues të procedojë me kryerjen e punimeve, në zbatim të projektit të miratuar me këtë leje ndërtimi.

Ky përcaktim jepet në pikën 16, të nenit 3, të Ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se: **“”Leje ndërtimi” është akti i miratimit të kërkesës për leje ndërtimi dhe i lejimit të punimeve përkatëse”. Sipas këtij përcaktimi taksativ ligjor, asnjë subjekt në territorin e Republikës së Shqipërisë, nuk mundet të kryejë punime ndërtimi nëse ai nuk është i pajisur paraprakisht me lejen përkatëse të ndërtimit.**

Nga ana tjetër, po t’i referohemi pikës 17, të nenit 3, të Ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, evidentojmë se në të përcaktohet shprehimisht që: “”Leje zhvillimi” është akti i përcaktimit të kushteve zhvillimore për një parcelë/pronë të caktuar, që shërben si bazë për pajisjen me leje ndërtimi”.⁴

Qartësisht nga përmbajtja e dispozitave të sipërcituara të ligjit, por edhe nga përgjigja e AZHT-së rezulton se, KKT-ja ka miratuar me vendimin nr.01, datë 20.11.2018, vetëm leje zhvillimore për objektin: “Rehabilitimi i segmentit rrugor “Mbikalimi i pallatit me shigjeta, rrethrotullimi “Shqiponja”, Bashkia Tiranë”, por jo një leje ndërtimi. Kjo leje ndërtimi ka munguar si një akt administrativ i domosdoshëm për lejimin e punimeve përkatëse në zonën e Astirit, gjatë kohës së përgatitjes të këtij raporti të veçantë. Ndërkohë, nga verifikimi i kryer në faqen “on line”, të AZHT-së,⁵ lidhur me vendimet e miratuara nga ana e KKT-së për kërkesat e paraqitura pranë saj për leje ndërtimi gjatë vitit 2019, rezulton se ende nuk ka një vendim të KKT-së për miratimin e një leje ndërtimi, për objektin “Rehabilitimi i

³ Këshilli Kombëtar i Territorit, përcaktohet si autoriteti përgjegjës për vendimmarrjen për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi për llojet e zhvillimit komplekse, të përcaktuara në rregulloren e zhvillimit dhe ato që lidhen me çështje, zona, objekte të rëndësishme kombëtare apo me investime strategjike për interesat e vendit, (pika 1, neni 28, i Ligjit nr. 107/2014).

⁴ Korelacioni ligjor ndërmjet dy nocioneve dhe akteve administrative konkrete respektive, jepet në nenin 37, të Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se: “Zhvillimi lejohet vetëm në kushtet e përcaktuara nga dokumentet e planifikimit ose, në mungesë të tyre, të aprovuara nga organi kompetent, të cilat shërbejnë si bazë për hartimin e dokumentacionit që shoqëron kërkesën për leje ndërtimi”.

⁵ Ky verifikim është kryer së fundmi, në datën 24.09.2019, në website; www.azht.gov.al

segmentit rrugor “Mbikalimi i pallatit me shigjeta, rrethrotullimi “Shqiponja”, Bashkia Tiranë”.

Në këto rrethana, të gjitha organet ligjzbatuese të përfshira në këtë proces kanë dështuar për të ndaluar punimet e kryera pa leje, apo edhe përgatitjet e kantierëve të ndërtimit pa leje, nga cilido subjekt tenderfitues, i dalë nga procedurat e tenderimit të zhvilluara nga ana e ARRSH-së.

- ii- Duke analizuar legjislacionin në fuqi, për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, është me vend të sjellim në vëmendje Ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, i cili i bën një trajtim shumë specifik procesit të këshillimit dhe takimit publik, nga ana e autoritetit përgjegjës për hartimin e dokumentit të planifikimit, përpara çdo vendimmarrje lidhur me dokumentet e planifikimit në nivel qëndror dhe me planin e përgjithshëm vendor. Specifikisht, lidhur me këtë proces, në nenin 24, përcaktohen afate procedurale konkrete ku parashikohet se, *“përmbledhja e vërejtjeve apo propozimeve gjatë takimit publik i bashkëlidhen projektit të dokumentit të planifikimit, të paraqitur për miratim dhe njoftohet së bashku me të nëpërmjet botimit në regjistër dhe një ose disa mjeteve tradicionale të informimit”*.⁶

Janë me rëndësi në kuadër të trajtimit të problematikave që po trajtojmë edhe disa përkufizime të tjera të Ligjit nr.107/2014, ku përcaktohet shprehimisht se:

- *“Ndërtim/punim pa leje” janë ato procese dhe/ose objekte ndërtimore të kryera në mungesë të lejes së ndërtimit, deklaratës paraprake për kryerjen e punimeve ose të kryera në kushtet e një lejeje të shfuqizuar”, (pika 21, neni 3);*
- *“Njoftim publik” është njoftimi paraprak i palëve të interesuara dhe/ose publikut, i kryer në kohë të mjaftueshme, nëpërmjet një ose disa prej mjeteve tradicionale të informimit, me qëllim informimin e palëve të interesuara për kohën, vendin dhe qëllimin e takimit publik, sipas këtij ligji” (pika 25, neni 3);*
- *“Palë e interesuar” është çdo person fizik, juridik, ose autoritet shtetëror apo organ i tij, të drejtat ose interesat e ligjshëm të të cilit, qofshin këta individualë ose të përbashkët, kanë të ngjarë të preken nga një dokument planifikimi, zhvillimi ose kontrolli të zhvillimit” (pika 26, neni 3);*
- *“Projektakt” janë projektvendimet e autoriteteve të planifikimit dhe projektet e dokumenteve të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit përpara se të jenë miratuar nga autoriteti përkatës” (pika 31, neni 3);*
- *“Punime apo punime ndërtimore” është çdo veprim ose proces për krijimin e ndërtimeve” (pika 32, neni 3);*
- *“Takim publik” është takimi i hapur, i organizuar, në vend të përshtatshëm dhe me afat lajmërimi të arsyeshëm nga autoriteti i planifikimit, i cili përmes njoftimit publik fton qytetarët, ekspertët dhe palët e interesuara të parashitë vërejtjet, komentet apo propozimet e tyre mbi projektaktin e dokumentit të planifikimit, zhvillimit apo kontrollit të zhvillimit përpara finalizimit të dokumentit të planifikimit, zhvillimit apo kontrollit të zhvillimit, të parashikuar nga ky ligj, nga autoriteti përkatës” (pika 40, neni 3);*

⁶ Shih pikën 4, të nenit 24, të Ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.

- *“Vërejtje” është mendimi kundërshtues për zgjidhjet e ofruara në projektaktin e dokumentit të planifikimit, zhvillimit apo kontrollit të zhvillimit ose një pretendim për mosrespektim të dispozitave ligjore apo nënligjore në procesin e planifikimit” (pika 43, neni 3).*

Ky proces mbart një rëndësi të veçantë pasi në thelb ruan balancën ndërmjet interesave private dhe atyre publikë, të ndërthurura në vendimmarrjet që lidhen me dokumentet e planifikimit, zhvillimit, apo kontrollit të zhvillimit të territorit.

- iii- Sikurse kemi theksuar që në fillim, shqetësimet e banorëve për njoftimet verbale që u janë bërë për prishjen e banesave ku ata janë strehuar, apo edhe të objekteve me destinacion tjetër përdorimi, fillojnë që nga fundi i muajit Tetor 2018 dhe kanë vazhduar përgjatë gjithë muajit Nëntor 2018, si edhe në muajt e tjerë pasardhës. Konkretisht, nga ankesa individuale të administruara rezultojnë se, ankesat janë paraqitur duke filluar nga data 1.11.2018 e në vazhdim në institucionin e Avokatit të Popullit, por problematika në fillesat e saj është shfaqur më herët, sipas njoftimeve të dhëna në media, së paku që nga muaji Prill - Shtator 2018.

Nga ana tjetër, në të gjitha këto ankesa ngrihet shqetësimi për mungesën e dijenisë nga ana e ankuesve, banorë të zonës së “Astirit”, për elementët e projektit të miratuar, që lidhet me punimet ndërtimore që prekin banesat e tyre gjatë zbatimit të tyre. Ndërhyrjet në pronësitë private në këtë zonë por edhe në pronësinë shtetërore, rezultojnë se kanë filluar efektivisht, para datës 20.11.2018, që, në fakt, lidhen me miratimin e lejes së zhvillimit.

Edhe në ankesa individuale, apo në ankesa të paraqitura në grup ankuesish në institucionin e Avokatit të Popullit, për njoftime që u janë bërë këtyre të fundit në rrugë verbale nga punonjës të ARRSH-së, apo edhe të Inspektoriateve përkatëse të Mbrojtjes së Territorit, rezultojnë se, individët apo subjektet përkatëse, banesat apo objektet e të cilëve përfshihen në gjurmën e projektit *“Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja, Loti 1, Loti 2”*, nuk kanë dijeni për projektin përkatës dhe nuk kanë qenë të njoftuar, apo pjesëmarrës në një proces paraprak të diskutimit dhe konsultimit publik të tij. Të tilla ankesa ku paraqitet ky shqetësim janë p.sh; ankesa e shtetases E.N (201802201), ankesa e shtetases N.Xh (201802277), ankesa e shtetasit F.D (201802245), ankesa e shtetasit L.M (201802175), etj.

Në shkresat tona drejtuar ARRSH-së kemi kërkuar ndër të tjera shprehimisht, shpjegime dhe kopje dokumentacioni lidhur me faktin:

- nëse ka patur një projekt të miratuar për vazhdimin e punimeve në Unazën e Re të Tiranës, përsa i takon zgjerimit të segmentit në zonën e Astirit;
- nëse ky projekt ka kaluar të gjitha fazat procedurale të miratimit të tij, sipas parashikimeve të Ligjit nr.107/2014;
- nëse është botuar dhe publikuar ky projekt në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, sipas kërkesave dhe parashikimeve të nenit 56, të Ligjit nr.107/2014;

- si dhe gjithçka tjetër lidhur me këtë çështje, duke zynuar në sqarimin sa më të shpejtë dhe përfundimtar të pretendimeve dhe shqetësimeve të ngritura prej ditësh nga ana e komunitetit të banorëve që do të preken nga zbatimi i projektit.

Pavarësisht kërkesave tona të detajuara mbi këtë problematikë dhe specifikisht mbi vendimmarrjen përkatëse të nevojshme, për miratimin e projektit për kryerjen e punimeve në Unazën e Re, të Tiranës, në zonën e Astirit, përgjigja që na është dërguar nga ana e ARRSH-së, me shkresën nr.10425/1 datë 26.11.2018, ka shprehimisht këtë përmbajtje:

“...Për këtë investim është hartuar projekti “Studim Projektim Rehabilitim i segmentit rrugor Mbikalimi i Pallatit me Shigjeta – Rrethrotullimi Shqiptar”, të hartuar nga konsulenti “AVE” shpk, sipas kontratës së Sponsorizimit me nr.3625/2 datë 25.05.2018.

Me vendimin e Këshillit Teknik të Autoritetit Rrugor Shqiptar nr.56 datë 4.09.2018 me nr.protokoll 7491 është miratuar ky projekt.

Me shkresën nr.prot.532 datë 13.11.2018 nga Ministria e Kulturës është miratuar Vendimi nr.462 datë 13.11.2018 “Për miratimin e Projektit Zhvillimor “Rehabilitim i Segmentit Rrugor Mbikalimi Pallati me Shigjeta – Rrethrotullimi Shqiptar”, Loti 1, Loti 2, Loti 3, Bashkia Tiranë, kërkesë e Autoritetit Rrugor Shqiptar.

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave, Këshillit Kombëtar të Territorit nr.01 datë 20.11.2018 është miratuar Leja e Zhvillimit për Objektin, Rehabilitim i Segmentit Rrugor Mbikalimi Pallati me Shigjeta – Rrethrotullimi Shqiptar”, Loti 1, Loti 2, Loti 3, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues Autoritetin Rrugor Shqiptar”.

Ndërkohë bashkëngjitur kësaj shkrese të ARRSH-së janë dërguar, një kopje e vendimit të Këshillit Teknik të Autoritetit Rrugor Shqiptar nr.56 datë 4.09.2018; një kopje e Horografisë së projektit të rrugës; një kopje e Vendimit nr.462 datë 13.11.2018 të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve, Ministria e Kulturës; një kopje e shkresës nr.532/1 datë 19.11.2018 të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve, drejtuar ARRSH-së; një kopje e vendimit nr.209 datë 25.09.2018 të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, Ministria e Kulturës; një kopje e shkresës nr.3718 datë 12.11.2018 e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Në asnjë informacion të dhënë nga ana e ARRSH-së, që lidhet me procesin e miratimit paraprak të projektit “Rehabilitim i segmentit rrugor, mbikalimi i “Pallatit me Shigjeta” – Rrethrotullimi “Shqiptar” (Lot.1, Lot.2, Lot.3), me vendimin e Këshillit Teknik të ARRSH-së, nr.56 datë 4.09.2018, nuk gjejmë dokumentacion zyrtar që vërteton ezaurimin e procedurave ligjore që kërkojnë kryerjen e njoftimit publik, takimeve publike, apo edhe të pasqyrimit të vërejtjeve, komenteve apo propozimeve të mundshme, të paraqitura nga palët e interesuara, ndaj projektit të hartuar nga subjekti “AVE” shpk, “Studim Projektim Rehabilitim i segmentit rrugor Mbikalimi i Pallatit me Shigjeta – Rrethrotullimi Shqiptar”. Nga analiza që i bëjmë akteve shkresore të nxjerra për këtë qëllim rezulton se, ky proces duhet të ishte kryer midis datës 4.09.2018 dhe në vijim, por nuk ka asnjë të dhënë dhe asnjë publikim në këtë periudhë kohore.

Kjo mungesë flet për një proces jotransparent dhe në shkelje flagrante të përcaktimeve ligjore sa i takon procesit të hartimit të projektit “Rehabilitim i segmentit rrugor, mbikalimi i “Pallatit me Shigjeta” – Rrethrotullimi “Shqiponja” (Lot.1, Lot.2, Lot.3).

Nuk ka asnjë përgjigje nga ana e ARRSH, se kur është bërë kërkesa e tyre pranë KKT, por ne prezumojmë se kërkesa është dërguar pas plotësimit të akteve që duhet t’i bashkëlidhen asaj. Një nga këto akte është edhe vendimi i Këshillit Kombëtar të Restaurimeve, përcjellë në ARRSH, vetëm 1 (një) ditë para vendimmarrjes së KKT.

Lehtësisht vërehet se, nuk ka asnjë sqarim apo kopje dokumentacioni zyrtar provues nga ana e ARRSH-së, në përgjigje të pyetjeve që kanë të bëjnë me, konsultimin paraprak dhe informimin e banorëve të zonës së Astirit mbi projektin që do të zbatohet atje, nëse ka patur një projekt të miratuar për vazhdimin e punimeve në Unazën e Re të Tiranës, përsa i takon zgjerimit të segmentit në zonën e Astirit, si dhe për pyetje të tjera të parashtruara nga ana jonë.

- iv-*** Nga inspektimet dhe monitorimet e vazhdueshme të kryera nga ana jonë në zonën e Astirit, ndër të tjera ka rezultuar se janë kryer ndërhyrje ndërtimore dhe prishje e pronës publike, në zona publike të destinuara për gjelbërim në zonën e Astirit, para vendimmarrjes së KKT.

Më konkretisht, me shkresën tonë nr.K3/E38-4 datë 19.11.2018, i jemi drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH-së, ku thuhet shprehimisht se:

“...janë konstatuar së fundmi disa zhvillime, të cilat kanë të bëjnë me zënien dhe njëkohësisht dëmtimin e hapësirave publike.

Më konkretisht, prej disa ditësh, sikurse është publikuar gjerësisht edhe nga ana e medias, është prishur pjesa e lulishtes publike ku ndodhej “Shqiponja”, në zonën fundore të Laprakës, kryqëzimi i rrugës së Durrësit me Unazën e Re, të Tiranës. Pikërisht në këtë vend, firma e ndërtimit “Salillari” sh.p.k. ka vendosur tashmë një kantier ndërtimi.

Po kështu kemi konstatuar se në rrethrotullimin e gjendur në zonën e Astirit, në afërsi të marketit për pajisje elektronike “O’Zone”, është zënë dhe dëmtuar njëkohësisht një hapësirë tjetër publike (lulishte), nga e njëjta firmë ndërtimi, e cila ka vendosur aty një kantier tjetër ndërtimi. Në një tabelë të vendosur në anë të rrugës kryesore nga ana e ARRSH-së, në afërsi të këtij kantieri të dytë, bie në sy fakti se ekspozohet si objekt punimesh, “Rehabilitimi i segmentit rrugor Mbikalimi, Pallati me shigjeta, Rrethrotullimi “Shqiponja”, Loti 2”, investitor “ARRSH”, projektues “Ave Consulting” shpk, Sipërmarrës “Salillari” sh.p.k., etj., por nuk jepet sipas kërkesave të ligjit, afati i fillimit dhe mbarimit të punimeve (megjithëse ka një përcaktim prej 24 muajsh!!!), si dhe leja zhvillimore mbi bazën e të cilave lejohet zhvillimi i këtyre punimeve.

Në këto rrethana dhe për arsye të shqyrtimit të mëtejshëm të kësaj problematike del e nevojshme të na sqarohet nga ana juaj, se:

1. Mbi ç'bazë ligjore është lejuar zënia e hapësirave të sipërcituara publike dhe transformimi i tyre në kantiere ndërtimi nga ana e firmës “Salillari” shpk?
2. Mbi ç'bazë ligjore është kryer vendosja e tabelës së sipërcituar nga ana juaj si ARRSH, në rrethrotullimin e gjendur në zonën e Astirit, në afërsi të marketit për pajisje elektronike “O’Zone”, në të dyja anët e rrugës kryesore?
3. Cili subjekt ka kryer prishjen e “Shqiponjës” të ndodhur tek rrethrotullimi që njihet me të njëjtin emër dhe a ka patur një akt zyrtar, që lejonte prishjen e kësaj veprë publike, kuptuar këtu edhe transformimin e lulishtes përkatëse në kantier ndërtimi?”.

Në përgjigjen e ARRSH-së, dhënë me shkresën nr.10492/1 datë 2.12.2018, thuhet shprehimisht se: “Autoriteti Rrugor Shqiptar ka lidhur kontratën me nr.7733/5 prot, datë 2.11.2018, me objekt “Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja, Loti 2”, me Shoqërinë “Salillari” shpk dhe Kontratën me nr.7732/5 datë 2.11.2018 me objekt, “Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja, Loti 1”, me Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë “Biba – X” & “DH ALBANIA”.

Tabelat informuese janë vendosur nga kontraktori i punimeve në mbështetje të kontratave të sipërcituara dhe zhvendosja e objektit të Shqiponjës, nuk është kryer nga Autoriteti Rrugor Shqiptar”.

Sikurse theksuam më lart, punimet e ndërtimit mund të fillojnë vetëm pasi subjekti përkatës të jetë pajisur me aktin administrativ të lejes së ndërtimit. Çdo veprim i kryer para daljes së këtij akti përbën veprim të kundërligjshëm për shoqëritë e ndërtimit, të ndëshkueshëm administrativisht, por edhe shpërdorim detyre për organet e administratës shtetërore, në nivel qëndror e vendor, që jo vetëm s’kanë reaguar por pranuan dhe mbështetën këto veprime.

Një konstatim paraprak ka të bëjë me faktin se, ARRSH-ja ka lidhur kontrata për zbatimin e projektit, “Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja, Loti 2”, me subjektin “Salillari” shpk, për zbatimin e projektit, “Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja, Loti 1”, me Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë “Biba – X” & “DH ALBANIA”, dhe për zbatimin e projektit ““Rehabilitimi i segmentit rrugor, mbikalimi i “Pallatit me shigjeta”- rrethrotullimi “Shqiponja”, Loti 3”, me bashkimin e operatorëve ekonomikë “Victoria Invest International & Victoria Invest shpk”, në të njëjtën datë dhe më konkretisht, në datë 2.11.2018.⁷ Lidhja e këtyre kontratave të zbatimit, si veprim juridik është kryer 18 ditë përpara miratimit të lejes së zhvillimit. Nuk është e qartë nëse në përmbajtjen e kontratave gjenden parashikime ku përcaktohet se, punimet nga ana e kontraktorit do të fillojnë vetëm pas nxjerrjes së vendimit nga ana e KKT-së, për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe miratimit të projektit përkatës të ndërtimit të veprës publike, pasi nuk na janë dërguar kopje të plota të këtyre kontratave nga ana e ARRSH-së. Ne cdo rast, është e qarte se cdo parashikim i tillë do të ishte në kundërshtim me ligjin dhe do të ngarkonte me përgjegjësi autoritetet shtetërore por edhe subjektet kontraktore. E njëjta vlen edhe për kryerjen e punimeve në fakt, pavaresisht parashikimit kontraktor persë cdo parashikim i tillë do të ishte në kundërshtim me një dispozitë urdheruese të ligjit, pra i pavlefshëm, dhe në asnjë rast sdo të mund prodhonte të drejta e detyrime për palet.

⁷ Edhe kjo kontrate rezultoi e lidhur pasi është pasi bërë publike problematika në media.

Ndërkohë, me shkresën tonë nr.K3/E38-5 datë 19.11.2018, i jemi drejtuar paralelisht edhe Kryeinspektorit të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), ku për të njëjtat konstatime të cituara edhe në shkresën e sipërcituar drejtuar ARRSH-së, kemi kërkuar shpjegime shprehimisht për këto pyetje:

“1. A është konstatuar nga ana juaj zënia e hapësirave të sipërcituara publike dhe transformimi i tyre në kantiere ndërtimi nga ana e firmës “Salillari” shpk?

2. Mbi ç’bazë ligjore është kryer dhe lejuar vendosja e tabelës së sipërcituar nga ana e ARRSH, në rrethrotullimin e gjendur në zonën e Astirit, në afërsi të marketit për pajisje elektronike “O’Zone”, në të dyja anët e rrugës kryesore?

3. Cili subjekt ka kryer prishjen e “Shqiponjës” të ndodhur tek rrethrotullimi që njihet me të njëjtin emër dhe a ka patur një akt zyrtar, që lejonte prishjen e kësaj vepre publike, kuptuar këtu edhe transformimin e lulishtes përkatëse në kantier ndërtimi?

4. Cilat janë masat e marra nga ana juaj si organ, ndaj këtyre zhvillimeve të konstatuara?”.

Në përgjigjen e dhënë nga ana e IKMT-së, me shkresën nr.4483/2 datë 27.11.2018, sqarohet shprehimisht se: *“Me shkresën nr.9765 prot, datë 5.11.2018, protokolluar pranë institucionit tonë me nr.4287 prot, datë 6.11.2018, Autoriteti Rrugor Shqiptar kërkon mbështetje për lirimimin e sheshit të ndërtimit nga objektet pa leje, për realizimin e projektit të Unazës së Madhe, segmenti rrugor “Mbikalimi pallati me shigjeta- rrethrotullimi shqiponja”. Deri në këto momente jemi në fazë verifikimi të situatës në terren, ndërsa në lidhje me prishjen e “Shqiponjës” të ndodhur në rrethrotullim, ju informojmë se IKMT-ja nuk ka mbajtur procedurë ligjore dhe nuk ka bërë asnjë veprim për heqjen e këtij monumenti”.*

Në vazhdim, për sqarimin e mëtejshëm të kësaj çështjeje i jemi drejtuar IMT-së në Bashkinë Tiranë, me shkresën tonë nr.K3/E38-10 datë 4.01.2019, duke parashtruar të njëjtat pyetje që i kishim parashtruar IKMT-së, në shkresën përkatëse. Ndërkohë në shkresën nr.1062 prot, datë 24.01.2019, të këtij organi publik drejtuar Avokatit të Popullit, thuhet ndër të tjera se:

“Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit Bashkisë Tiranë, nuk ka dijëni zyrtare për miratimin e këtij projekti apo leje zhvillimore në segmentin nga “Mbikalimi i pallatit me shigjeta – rrethrotullimi “Shqiponja””.

Nga ana e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit nuk është marrë pjesë në ndërhyrjen për prishje të objekteve që pengojnë zhvillimin e këtij projekti”.

- v- Për një proces të mirëmennduar dhe efektiv të realizimit të një vepre publike, nevojitet gjithashtu një studim shoqëruar i fizibilitetit, Nga shqyrtimi i ankesave individuale që lidhen me këtë problematikë, rezultoi se në shkresën nr.10426/1 datë 27.11.2018 të ARRSH-së, thuhet ndër të tjera se:

“...nga ana e Autoritetit Rrugor Shqiptar më datën 20.11.2018 janë ngritur tre grupe pune në kuadër të shpronësimeve për segmentin rrugor “Rehabilitimi i segmentit rrugor Mbikalimi Pallati me Shigjeta Rrethrotullimi Shqiponja”, në të cilën do të bëhen të gjitha verifikimet e thelluara mbi posedimet e të gjitha pasurive faktike, si ato posedues të aktit të pronësisë edhe ato që janë në proces legalizimi.

Në zbatim të ligjit nr.85561, datë 22.12.1999 “Për shpronësim dhe marrje në përdorim të përkohshëm të pasurive prone private për interes publik”, si edhe akteve nënligjore në zbatim të

tij Autoriteti Rrugor Shqiptar është në fazën e vlerësimeve paraprake (identifikimin e pronarëve, matjet sipas projektit, caktimi i sipërfaqes që do të shpronësohet etj), për t'i drejtuar më pas Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, duke kërkuar miratimin e kërkesës për shpronësim”.

Studimi shoqëruar i fizibilitetit duhet të ishte pjesë e vendimit të Këshillit Teknik të Autoritetit Rrugor Shqiptar, me nr.56 datë 4.09.2018. Ky studim ka munguar në fakt, apo “në rastin më të mire” mund të jetë pjesor dhe i papërfunduar, siç edhe del nga analiza e të gjitha informacioneve të dhëna nga ana e organeve përkatëse publike, të përfshira në problematikën e zonës së Astirit. Për më tepër, vërehet një lloj konfuzioni dhe kontradikte në informacionet zyrtare të dhëna lidhur me ngritjen e grupeve të punës, apo grupeve verifikuese, para dhe pas nxjerrjes nga ana e Këshillit Kombëtar të Territorit të Vendimit nr.01 datë 20.11.2018, ku miratohet Leja e Zhvillimit për Objektivin, Rehabilitim i Segmentit Rrugor Mbikalimi Pallati me Shigjeta – Rrethrotullimi Shqiponja”, Loti 1, Loti 2, Loti 3, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues Autoritetin Rrugor Shqiptar”.

Ky konkluzion bëhet më i qartë, po t'i referohemi shkresës nr.42163 datë 22.11.2018, të Bashkisë Tiranë, drejtuar Avokatit të Popullit, ku thuhet ndër të tjera shprehimisht se:

“Në terren kanë qënë të pranishëm tre grupe pune të përbërë nga përfaqësues të institucioneve:

- 1. Autoritetit Rrugor shqiptar*
- 2. Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave Ndërtimeve Informale,*
- 3. Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit,*
- 4. Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme,*
- 5. Bashkisë Tiranë.*

Vlerësimet social-ekonomike në terren janë realizuar nga grupet e punës të përbërë nga punonjës social/psikolog, administrator shoqëror, urbanistë të njësive administrative përkatëse, përgjegjësi dhe specialist nga Drejtoria e Strehimit Social. Grupi ka patur për qëllim evidnetimin e situates reale të kushteve social ekonomike dhe kushteve të strehimit të familjeve që preken nga projekti. Këto të dhëna janë përpunuar në një database të vetëm dhe përcjellë ARRSH, për të vijuar koordinim e proceseve në vijim të këtij projekti.

Vlerësimi në terren është bërë në bazë të vetëdeklarimit të familjarëve dhe personave që posedojnë biznese ose aktivitete që gjenerojnë të ardhura. Puna në terren ishte parakusht për qartësimin e gjurmës së projektit e gjendjen reale në terren”.

Përfundimisht, mbi bazën e gjetjeve dhe informacionit të vënë dispozicion nga ana e ankuesve si dhe nga ana e organeve përkatëse publike, arrihet në konkluzionin se subjektet e interesuara por edhe qytetarët në tërësi kanë mungesë informacioni për projektin e sipërcituar dhe nuk ka patur një proces konsultimi publik me subjektet e interesuara gjatë fazës së hartimit të projekt-idesë, ashtu siç e kërkon legjislacioni në fuqi. Deri para datës 20.11.2018, nuk ka patur informacion apo njoftim zyrtar mbi projektin që do të zbatohet, vendimin paraprak të Këshillit Teknik të ARRSH-së, koston totale të projektit, koston e planifikuar për shpronësimin e subjekteve përkatëse, i cili në bazë të kuadrit ligjor që rregullon procedurat e shpronësimit, duhet të

realizohet në favor të banorëve përpara ndërhyrjes fizike ndaj objekteve ku ato banojnë apo ushtrojnë aktivitetin e tyre.

Projekti përkatës për ndërtimin e segmentit rrugor “Rehabilitimi i segmentit rrugor Mbikalimi Pallati me shigjeta Rrethrotullimi Shqiponja”, është hartuar dhe miratuar në mungesë të transparencës, pa kryer një studim të nevojshëm dhe të kujdesshëm të pronësive që ai prek, si dhe të pasojave komplekse që ai sjell, në shumë aspekte.

Prishja e objektit “Shqiponja”, si dhe zënia e hapësirave publike, të konstatuara nga jonë, të përdorura si kantiere ndërtimi prej kompanive përkatëse private është kryer pa patur lejen e ndërtimit, që mundëson fillimin e punimeve për zbatimin e projektit për ndërtimin e segmentit rrugor “Rehabilitimi i segmentit rrugor Mbikalimi Pallati me Shigjeta Rrethrotullimi Shqiponja”. Prona publike dhe ato private janë dëmtuar në këto kushte në kundërshtim me ligjin.

Natyra e përgjigjeve të dhëna nga ana e organeve publike, përgjigje këto të paplota dhe kontradiktore, tregon vullnet për të anashkaluar ligjin apo për të kryer punime të kundërligjshme, por edhe për të mënjanuar dhënien e llogarisë apo ushtrimin e kompetencave ligjore, në rastin e organeve të IKMT, apo IMT.

Konstatohet se nga veprimet dhe mosveprimet e këtyre dy institucioneve shtetërore u janë garantuar përfitime materjale ose jopasurore subjekteve ndërtuese që kanë kryer punime në këtë objekt e njëkohësisht janë dëmtuar haptazi në mënyrë flagrante interesat e ligjshme të shtetit dhe shtetasve të cilët si rrjedhojë e punimeve të kryera pa leje dhe pa projekt të miratuar ligjërisht kanë dëmtuar infrastukturën rrugore e njëkohësisht dhe pronat e personave që jetojnë pranë aksit rrugor përkatës.

3. Procesi i ndjekur nga ana e ARRSH-së.

Në kuadër të hetimit administrativ të kësaj çështjeje nga ana jonë, i janë kërkuar shpjegime ARRSH-së, ALUIZNI-t dhe Bashkisë Tiranë, lidhur me pretendimet dhe shqetësimet e banorëve të zonës. Konkretisht nga ana e Autoritetit Rrugor Shqiptar janë kërkuar shpjegime lidhur me faktin:⁸ nëse kishin komunikime dhe kërkesa zyrtare nga institucione të tjera shtetërore në kuadër të këtij projekti dhe si po trajtoheshin në vijim nga ana e Autoritetit Rrugor Shqiptar pretendimet dhe shqetësimet e banorëve në zonën e Astirit; nëse ishin konsultuar dhe informuar paraprakisht banorët e zonës së Astirit mbi projektin që do të zbatohet; nëse ishin evidentuar familjet që mund të prekeshin nga ky projekt dhe prishja e banesave apo objekteve të tjera në posedim të tyre dhe sa ishte numri i shtetasve dhe pasurive që mund të prekeshin nga zbatimi i këtij projekti; nëse kishte patur ndryshime apo devijime të projektit përfundimtar me ato variante që ishin paraqitur dhe prezatuar në vitin 2017 dhe cilat kishin qenë shkaqet ligjore të ndryshimeve apo rishikimeve të ndërmarra, duke patur parasysh faktin se nga ana e disa banorëve është shprehur qëndrimi se ndryshimet janë kryer në mënyrë selektive, abuzive dhe ka dyshime për afëra korruptive për të favorizuar subjekte të veçanta në këtë zonë për të shmangur ndërhyrjet në objektet e tyre shumëkatëshe, apo edhe ato të cilët do të shfrytëzonin më pas ndryshimet e projektit për ndërtime të larta; cili ishte organi dhe akti me të cilin ishte miratuar projekti, sa ishte vlera e tij

⁸ Shkresa e Avokatit të Popullit, me nr. K3/K45-8 datë 16.11.2018.

dhe nëse mund të ndiqeshin paraprakisht procedurat e shpronësimit të këtyre shtetasve, ashtu siç parashikohet në Ligjin Nr.8561 datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; sa ishte vlera totale e shpronësimeve dhe cilat ishin shkaqet që nuk inicioheshin paraprakisht këto procedura shpronësimi, para se të ndërhyhej forcërisht ndaj objekteve të banimit dhe shërbimit; si dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me këtë çështje, duke synuar në sqarimin sa më të shpejtë dhe përfundimtar të pretendimeve dhe shqetësimeve të ngritura prej ditësh nga komuniteti i banorëve që do të preken nga zbatimi i këtij projekti.

Për të patur një informacion më të detajuar, në vazhdim, i është kërkuar Drejtorit të ARRSH-së,⁹ një informacion edhe më i zgjeruar. Në përgjigje të kërkesës tonë për shpjegime, nga ana e Drejtorit të Autoritetit Rrugor Shqiptar jemi informuar me shkresën me nr. 10425/1 prot, datë 26.11.2018 se, për këtë investim ishte hartuar projekti “*Studim Projektim Rehabilitim i segmentit Rrugor “Mbikalimi i Pallatit me Shigjeta-Rrethrotullimi Shqiptonja”*”, hartuar nga konsulenti “AVE” sh.p.k, sipas kontratës së Sponsorizimit me nr. 3625/2 datë 25.05.2018. Ndërkohë që thekson më tej se, ky projekt është miratuar me Vendimin nr. 56 datë 04.09.2018, të Këshillit Teknik të Autoritetit Rrugor Shqiptar. Në këtë kuadër, është i paqartë raporti dhe marrëdhënia e iniciuar mes ARRSH-së dhe subjektit që ka hartuar projektin, aq më tepër, ***bazuar në një kontratë sponsorizimi, term dhe akt i panjohur dhe aplikuar në vendin tonë.***

Nga përmbajtja e shkresës së Autoritetit Rrugor Shqiptar, me nr. 10425/1 prot, datë 26.11.2018, si dhe dokumentacioni bashkëngjitur saj, konstatohet fakti se, Bashkia Tiranë është kërkuesi dhe financuesi i projektit “*Studim Projektim Rehabilitim i segmentit Rrugor “Mbikalimi i Pallatit me Shigjeta-Rrethrotullimi Shqiptonja”*”, ndërkohë që ARRSH është zbatuesi i saj.

Në gjykimin tonë nuk kemi patur një qëndrim konkret të ARRSH-së, në vijim të kërkesave tona të parashtruara në shkresën tonë të dytë zyrtare, lidhur me projektin e miratuar për vazhdimin e punimeve në Unazën e Re të Tiranës, përsa i takon zgjerimit të segmentit në zonën e Astirit, shqyrtimin e tij në të gjitha fazat procedurale të miratimit të tij, sipas parashikimeve të Ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, si edhe faktin nëse ishte botuar dhe publikuar ky projekt në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, sipas kërkesave dhe parashikimeve të nenit 56, të Ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.

Lidhur me procedurat ligjore të ndërmarra nga ARRSH-ja, për pajisjen me dokumentacionin respektiv për kryerjen e punimeve, nga ana e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit jemi informuar përmes shkresës me nr. 2116/1 prot. datë 26.12.2018, përsa u përket veprimeve të ndëmarra nga ARRSH, duke theksuar faktin se Autoriteti Rrugor Shqiptar, në cilësinë e zhvilluesit të projektit kishte aplikuar në sistemin “e-leje”, për pajisje me Leje Zhvillimi për “*Rehabilitimi i segmentit Rrugor “Mbikalimi i Pallatit me Shigjeta-Rrethrotullimi Shqiptonja, Bashkia Tiranë”*”. Në informacionin e dërguar nga AZHT nuk theksohet data e aplikimit nga ana e ARRSH-së, për pajisje me leje zhvillimi.

Në vijim, duhet theksuar fakti se në rastin konkret është miratuar një Leje Zhvillimi, e cila referuar nenit 3, pika 17, të Ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i

⁹ Shkresa e Avokatit të Popullit me nr. K3/K45-8 prot, datë 16.11.2018.

ndryshuar “... është akti i përcaktimit të kushteve zhvillimore për një parcelë/pronë të caktuar, që shërben si bazë për pajisjen me leje ndërtimi.”

Siç rezulton nga ky qëndrim i Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, nga ana e Autoritetit Rrugor Shqiptar, në cilësinë e zbatuesit të projektit “Rehabilitimi i segmentit Rrugor “Mbikalimi i Pallatit me Shigjeta-Rrethrotullimi Shqiponja, Bashkia Tiranë”, janë ndërmarrë veprime konkrete në dëm të pasurive të shtetasve që banojnë në zonën e Astirit, pa qenë të pajisur me një leje ndërtimi. Në rastin konkret, ky projekt prek një numër të madh banorësh, posedues prej vitesh të objekteve të shfrytëzuara nga ana e tyre për qëllime banimi apo shërbimi. Mungesa e lejes së ndërtimit përbën një cënim të rëndë dhe flagrant të të drejtave themelore të qytetarëve, për shkak të ndërhyrjes së realizuar ndaj objekteve të banorëve të zonës së Astirit.

E drejta e pronës, si një e drejtë themelore dhe shumë e rëndësishme në një shtet demokratik, e garantuar dhe sanksionuar në nenin 41, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 1, të Protokollit 1, të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut,¹⁰ duhet të zbatohet efektivisht nga çdo organ i administratës shtetërore. Shkeljet e kësaj të drejte jo vetëm cënojnë elementët thelbësorë të shtetit të së drejtës, por janë edhe tregues i pastër i keqadministrimit dhe/ose korrupsionit, qoftë në formën klasike të shprehur me përfitim monetar, ashtu edhe përmes përfitimit të funksionit.

Për më tepër, nga informacioni zyrtar¹¹ i marrë gjatë përgatitjes së këtij raporti evidentohet se, ka qenë Autoriteti Rrugor Shqiptar që ka kërkuar heqjen e pemëve si dhe heqjen e shtyllave të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, në zonën e Astirit, pa dalë ende leja e ndërtimit, fakt që konstaton shkelje të rënda që çojnë në përgjegjësi administrative por edhe penale.

4. Procedurat e shpronësimit.

E drejta e pronës, si e drejtë themelore e njeriut, afirmohet dhe garantohet në nenin 41, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se: “E drejta e pronës private është e garantuar”. Garantitë për respektimin dhe mbrojtjen e kësaj të drejte zgjerohen në nenin 1 të Protokollit nr.1 të Konvetës Europiane të të Drejtave të Njeriut, ku thuhet shprehimisht se: “Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën që t’i respektohet pasuria e tij”.

Megjithëse një e drejtë themelore e garantuar, e drejta e pronësisë nuk është një e drejtë e paprekshme. Formulimi i bërë në nenin 41, të Kushtetutës, ku thuhet se:

“...3. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë.

4. Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë.

5. Për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë”,

¹⁰ Neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ-së parashikon shprehimisht se:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij.

Askush nuk mund të privohet nga pasuria e tij, përveçse për një interes publik dhe duke ju nënshtruar kushteve të parashikuara me ligj dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

¹¹ Shkresa nr.1071 prot, datë 14.11.2018, e ARSH-së drejtuar Bashkisë Tiranë.

pranon në mënyrë pohuese se ekziston mundësia që e drejta e pronësisë mund të kufizohet, por vetëm përjashtimisht dhe në kushte të mirëpërcaktuara.

Kufizimet e së drejtës të pronës private (shpronësimi apo kufizime që barazohen me shpronësimin), legjitimohen që të ndodhin vetëm në rrethana qartësisht të përcaktuara në ligj. Pra, shteti mund t'i privojë individët nga prona ose pasuritë e tyre, vetëm në kushtet e përmbushjes së një interesi publik, kundrejt një shpërblimi të drejtë, dhe në respektim të së drejtës së ankimit, të individit të cënuar për masën e shpërblimit. Sigurisht që kjo vlerësohet nga autoritetet kombëtare në përputhje me njohjen e nevojave të drejtpërdrejta të shoqërisë. Në këtë drejtim shteti ka hapësirë mjaft të gjerë vlerësimi lidhur me kriterin e interesit publik. Megjithatë vendimi duhet të jetë i mbështetur qartazi në një bazë të arsyeshme. Pra, qëllimi i shpronësimit për interes publik duhet të jetë i ligjshëm dhe i arsyeshëm. Në vlerësimin e interesit publik duhet respektuar gjithashtu parimi i proporcionalitetit. Sa më sipër është e qartë se ndërhyrja në të drejtën e pronës bëhet vetëm për shkaqe të përcaktuara në ligj, në mënyrë shteruese, dhe sipas një procedure që respekton të drejtën themelore për një proces të rregullt ligjor.

E drejta e shtetasve për t'u mbrojtur nga veprimet arbitrare të shpronësimit, parashikohet edhe në Nenin 1, të Protokollit 1, të Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut, ku ndër të tjera thuhet se: *“Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”*.

E drejta e ligjvënësisë që, për arsye të ekzistencës së interesit publik, të mund të kufizojë hapësirën e disponimit të pronës private, me qëllim që një ndërhyrje e tillë ndaj të drejtës së pronës të jetë e justifikuar, është e domosdoshme që të ekzistojë edhe një marrëdhënie përpjestimore midis mjeteve të përdorura dhe synimit që kërkohet të realizohet. Mbi këtë bazë, sistemi ligjor përmban një sërë garancish materiale dhe procedurale. Në këto kushte, u takon organeve të autorizuara nga Ligji nr.8561, datë 22.12.1999 *“Për shpronësimet dhe për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”* për të bërë, rast pas rasti, vlerësimin si për ekzistencën e problemit të interesit publik që për ligj kufizimin e të drejtës së pronës, ashtu edhe të masave që duhen marrë për të ndrequr situatën, nëpërmjet kompensimit të drejtë të pronës. Çështja e detyrimit për dëmshpërblim në vetvete dhe kufijtë e tij përcaktohen nga rrethanat e secilit rast konkret.

Qëllimi i Ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 *“Për shpronësimet dhe për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”*, i ndryshuar, është shpronësimi dhe marrja në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për një interes publik, në atë masë sa është e domosdoshme për realizimin e qëllimit të shpronësimit, por gjithmonë, në çdo rast kundrejt një shpërblimi të drejtë.

E drejta e pronës mbrohet dhe garantohet në mënyrë të veçantë nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila ka tashmë një jurisprudencë të pasur në interpretimin e normave të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Nisur nga rëndësia dhe vlera e veçantë që ka e drejta e pronës, garantuar dhe sanksionur në Konventë, si edhe në Protokollin 1 shtesë të saj, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka interpretuar dhe elaboruar edhe aspekte të veçanta të të drejtës së pronës, siç është edhe shpronësimi për interes publik.

Gjykata rithekson që marrja e pasurisë mund të justifikohet vetëm nëse tregohet, ndër të tjera, që të jetë “*në interesin publik*” dhe “*sipas kushteve të parashikuara nga ligji*”. Çdo ndërhyrje në të drejtën e pronësisë duhet gjithashtu të plotësojë kërkesën e proporcionalitetit. Siç është shprehur Gjykata në mënyrë të përsëritur, duhet të arrihet një ekuilibër i drejtë ndërmjet kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesës për mbrojtjen e të drejtave themelore të individit¹².

Në lidhje me këtë, marrja e pasurisë pa pagesë të një shume proporcionale me vlerën e saj normalisht do të përbëjë një ndërhyrje joproporcionale, ndërsa një mungesë totale e kompensimit mund të konsiderohet e justifikueshme sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 vetëm në rrethana të jashtëzakonshme¹³. Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se “*vonesat jonormale në pagimin e kompensimit për shpronësim çojnë në humbje financiare shtesë për personin, toka e të cilit është shpronësuar, duke e vënë atë në një pozitë të pasigurisë*”¹⁴. E njëjta vlen edhe për vonesat jonormale në procedurat administrative ose gjyqësore përmes të cilave përcaktohet kompensimi i tillë, sidomos kur njerëzit tokën e të cilëve janë shpronësuar janë të detyruar të përdorin këto procedura për të përfituar kompensimin për të cilin kanë të drejtë.¹⁵

Përsa i përket procesit të shpronësimit, në rastin konkret ka patur deklarata mediatike të disa përfaqësuesve të institucioneve shtetërore qendrore dhe vendore të përfshira në këtë proces, të cilët në disa raste kanë qenë në tejkalim të dukshëm të kompetencave të tyre, madje edhe duke imponuar në këtë mënyrë qëndrimin dhe vendimmarrjen e ALUIZNI-t, për objekte të vetëdeklaruar për legalizim. Në këto deklarata mediatike është shprehur apriori dhe pa një analizë të thelluar qëndrimi se, objektet që nuk plotësojnë kriteret e legalizimit, duhet të përjashtohen nga ky proces. Institucioni shtetëror për verifikimin e respektimit të kriterëve ligjore të përjashtimit apo kualifikimit nga procesi i legalizimit është ALUIZNI (sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës) dhe jo ARRSH-ja, apo Bashkia Tiranë.

Nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit, për kohën që kjo problematikë ka qenë në shqyrtim nuk është administruar asnjë dokumentacion ligjor në bazë të të cilit konfirmohej fakti se, kishin filluar paraprakisht, apo se do të zbatohen procedurat e shpronësimit për subjektet që do të prekeshin nga zbatimi i projektit “*Rehabilitimi i segmentit Rrugor “Mbikalimi i Pallatit me Shigjeta-Rrethrotullimi Shqiponja, Bashkia Tiranë*”. Kjo ka ndodhur pavarësisht faktit se në këtë zonë ka pasur dhe ka pasuri me dokumentacion të rregullt pronësie, apo edhe subjekte që kanë vetëdeklaruar objektet e tyre për legalizim prej vitesh pranë ALUIZNI-t, në rrethanat kur ky i fundit ende nuk ka qenë shprehur me një vendim përfundimtar mbi kualifikimin, apo përjashtimin nga procesi i legalizimit të këtyre objekteve.

Një ndër problematikat thelbësore të evidentuara nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit gjatë hetimit dhe shqyrtimit të ankesave individuale, që lidhen me zbatimin e projektit “*Rehabilitimi i segmentit Rrugor “Mbikalimi i Pallatit me Shigjeta-Rrethrotullimi Shqiponja,*

¹² Shih çështjen *B. Tagliaferro & Sons limited and Coleiro Brothers Limited v. Malta*, Applications nos. 75225/13 and 77311/13, vendimi i datës 1.09.2018.

¹³ Shih *Former King of Greece and Others v. Greece [GC]*, no. 25701/94, § 89, ECHR 2000-XII, and *The Holy Monasteries v. Greece*, 9 December 1994, § 71, Series A no. 301-A

¹⁴ Shih çështjen *Akkuş kundër Turqisë*, 9 korrik 1997, § 29.

¹⁵ Shih çështjen *Aka kundër Turqisë*, 23 shtator 1998.

Bashkia Tiranë”, është edhe fakti i përfshirjes në procedurat e shpronësimit të pasurive të paluajtshme, të ligjshme, të individëve të caktuar,¹⁶ pa dijeninë e tyre (pra pa u njoftuar zyrtarisht për këtë fakt nga autoriteti përfitues prej procesit të shpronësimit) dhe pa u ndjekur dhe respektuar procedurat dhe afatet që parashikon kuadri ligjor në fuqi, mbi shpronësimin e pasurisë për interes publik¹⁷. Ky fakt rëndohet më tej, kur këto pasuri të përfshira në proces shpronësimi jo vetëm nuk janë shpronësuar, në mënyrë që pronari i tyre të përfitojë dëmshpërblimin e drejtë që i takon ligjërisht, por janë dëmtuar ndërkohë si pasojë e ndërhyrjeve teknike të kundërligjshme dhe me pasoja të një dëmi jashtëkontraktor, të kryera prej organeve përgjegjëse për kontrollin e ligjshmërisë së ndërtimeve, në rang vendor, sikurse IMT, në Bashkinë Tiranë.

Lidhur me procedurat e shpronësimit, duket theksuar fakti se Këshilli i Ministrave, në mbledhjen e datës 17.04.2019 ka miratuar ndër të tjera edhe, Vendimin “*Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i segmentit rrugor “Pallati me shigjeta – rrethrotullimi “Shqiponja”*”¹⁸.

Sikurse konstatohet VKM¹⁹-ja e sipërcituar është miratuar rreth gjashtë muaj pas fillimit të procedurave dhe veprimeve konkrete nga autoritetet shtetërore ndaj pasurive dhe objekteve që ndodhen në zonën, ku efektivisht ka filluar të zbatohet projekti, “*Rehabilitimi i segmentit Rrugor “Mbikalimi i Pallatit me Shigjeta-Rrethrotullimi Shqiponja, Bashkia Tiranë*”. Fillimisht ishte i paqartë dhe jo transparent numri i pasurive që do t’i nënshtroheshin procesit të shpronësimit. Kjo pasaktësi dhe mungesë transparence me të dhënat zyrtare, është konstatuar nga ana jonë edhe gjatë procesit të shqyrtimit të ankesave specifike, si edhe hartimit të këtij raporti të veçantë.

Aktualisht, nga ana e Avokatit të Popullit konstatohet fakti se në bazë të VKM 231/2019, procesit të shpronësimit do t’i nënshtrohen 209 pasuri, ndër të cilat disa kanë edhe shumë bashkëpronarë. Pra, numri i shtetasve të prekur nga këto procedura është mjaft i madh, në krahasim edhe me numrin e pasurive. Gjithashtu, duhet theksuar fakti, se nga ana e autoriteteve shtetërore është ndërhyrë tashmë ndaj disa pasurive të paluajtshme, ndërkohë që pronarët e tyre ende nuk ishin apo ende nuk i janë nënshtuar procedurave të shpronësimit.

Shpronësimi do të fillojë menjëherë, me botimin e këtij vendimi në fletoren përkatëse zyrtare. Vlera e parashikuar e shpronësimit është 1 224 874 430.42 (një miliard e dyqind e njëzet e katër milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e katërqind e tridhjetë pikë dyzet e dy) lekësh, për pasuritë e llojit “truall”, “tokë arë” dhe “ndërtesë”, të cilat do të përballohen nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë. Në bazë të pikës 8, të këtij VKM-je të miratuar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, në

¹⁶ Ky rast i përket ankesës së shtetasës N.D, të regjistruar në sistemin e administrimit të ankesave në institucionin e Avokatit të Popullit, “Doculive”, me numrin 201802429.

¹⁷ Shih Ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 “*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*”, i ndryshuar.

¹⁸ Informacion i marrë nga faqja zyrtare e Këshillit të Ministrave: <https://www.kryeministria.al/newsroom/vendime-te-miratuara-ne-mbledhjen-e-keshillit-te-ministrave-date-17-prill-2019/>.

¹⁹ Shih VKM nr. 231 datë 17.04.2019 “*Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i segmentit rrugor “Pallati me Shigjeta-rrethrotullimi “Shqiponja”*”, botuar në Fletoren zyrtare nr. 55 datë 19.04.2019.

bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, do të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, si dhe të bëjë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

Sikundër përcaktohet në legjislacionin në fuqi, Këshilli i Ministrave vendos shpronësimin në rastet kur, propozimi për shpronësim gjendet i bazuar në ligj dhe në fakt. Vendimi i shpronësimit duhet të përmbajë; Qëllimin dhe shkakun ligjor të shpronësimit; pasuritë prone private që shpronësohen dhe pronarët përkatës; masën e shpërblimit për pronarët që shpronësohen, për pronarët e pasurive që zhvlerësohen, për personat e tretë që kompensohen për të drejtat e tyre për shkak të pronësimit, si dhe afatin dhe mënyrën e pagimit të tyre; afatin e fillimit dhe të mbarimit të shpronësimit, si dhe organin ose subjektin që merr në përdorim pasuritë prone private të shpronësuara; afatin e fillimit dhe të përfundimit të punimeve për projektin dhe investimin ose për realizimin e qëllimit të shpronësimit; vlerën e shpenzimeve të procedurës së shpronësimit në ngarkim të kërkuesit të shpronësimit.²⁰

Sikurse rezulton, Këshilli i Ministrave ka nxjerrë nr. 231 datë 17.04.2019 “*Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i segmentit rrugor “Pallati me Shigjeta-rrethrotullimi “Shqiponja”*”. Nisur nga kriteret ligjore të sipërcituara për përmbajtjen e këtyre akteve, që nxirren nga ana e Këshillit të Ministrave, në rast shpronësimi për interes publik, konstatohet se VKM nr. 231 datë 17.04.2019, në të 11 pikat e përmbajtjes së tij, nuk përcakton shprehimisht afatin dhe mënyrën e pagimit për pronarët që shpronësohen, për pronarët e pasurive që zhvlerësohen, për personat e tretë që kompensohen për të drejtat e tyre për shkak të pronësimit. Po kështu, ky VKM nuk përcakton shprehimisht, afatin e fillimit dhe të mbarimit të shpronësimit, si dhe afatin e fillimit dhe të përfundimit të punimeve për projektin dhe investimin, ose për realizimin e qëllimit të shpronësimit.

Risjellim në vëmendje faktin se, nga eksperiencia e trajtimit të çështjeve të tjera të marra në shqyrtim nga ana e Avokatit të Popullit, me objekt shpronësimin për interesa publik, kemi konstatuar se përpara fillimit të procedurave të shpronësimit dhe kompensimit të subjekteve, fillohet me punimet publike, duke përbërë dhe evidentuar në këtë mënyrë, cënim të të drejtave të pronësisë së pronarëve.

Avokati i Popullit, bazuar në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në Ligjin Nr.8561, datë 22.12.1999 “*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*”, i ndryshuar, konkretisht në nenin 3, të tij, ku thuhet se:

“Shpronësimi dhe marrja në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private realizohet në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në këtë ligj, duke garantuar transparencën, barazinë e shtetasve dhe mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tyre pasurore”,

thekson faktin se, mënyra e garantimit dhe mbrojtjes të së drejtave të pronësisë të shtetasve që shpronësohen, duhet të zhvillohet përmes një procedure të rregullt ligjore shpronësimi, duke

²⁰ Shih nenin 21, të Ligjit nr. 8561 date 22.12.1999 “*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*”, i ndryshuar.

patur parasysh likujdimin e plotë për vlerën e shpronësimit të subjektit, si edhe përcaktimin e një afati përmbysës së këtij procesi brenda një kohë sa më të shkurtër dhe të arsyeshme, si pjesë e një procesi të rregullt administrativ. Pagesa e dëmshpërblimit mund t'i nënshtrohet shtyrjeve ose mënyrës së pagimit me këste, por në asnjë rast personat nuk duhet dhe nuk mund të humbasin të drejtën e gëzimit të sendit, pa marrë plotësisht pagesën e dëmshpërblimit.

5. Veprimtaria e Agjensisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI-t). (Arbeni)

Bazuar në parashikimet e Ligjit nr.9482/2006 “Për legalizimin, urbanizimin, dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, ALUIZNI është organi i cili vendos për kualifikimin, dhe me këtë rast për lëshimin e lejes së legalizimit për ndërtimin informal, ose përjashimin nga procesi i legalizimit të ndërtimeve informale të vetëdeklaruar nga subjektet, të cilët i kanë ndërtuar ato.

Veprimtaria e ALUIZNI-t Tiranë, në procesin e shqyrtimit të vetëdeklarimeve të kryera prej subjekteve të cilët kanë ndërtuar ndërtime informale, në të dy anët e segmentit rrugor “Mbikalimi i Pallatit me Shigjeta – Rrethrotullimi Shqiponja”, është bërë objekt hetimi administrativ nga ana jonë, bazuar në shqyrtimin e problematikave të hasura dhe të ankesave individuale të paraqitura në institucionin e Avokatit të Popullit.

Institucioni i Avokatit të Popullit, i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t, si dhe Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Tirana – Veri, me disa shkresa²¹, informacion dhe shpjegime nëse janë kryer komunikime, kërkesa zyrtare nga institucione të tjera shtetërore në kuadër të këtij projekti dhe si po trajtohen në vijim nga ana e ALUIZNI Tirana - Veri pretendimet dhe shqetësimet e banorëve në zonën e Astirit; nëse janë iniciuar procese legalizimi për pasuritë e banorëve në këtë zonë dhe sa është numri i subjekteve vetëdeklarues dhe objekteve për legalizim; rreth procedurave që po ndiqen aktualisht nga ALUIZNI Tirana - Veri për këto pasuri, duke specifikuar konkretisht ato pasuri, apo objekte, që mund të jenë pjesë e projektit; rreth periudhës kohore gjatë së cilës ALUIZNI ka verifikuar dokumentacionin e paraqitur për legalizim, dhe nëse janë evidentuar mangësi në dokumentacionin tekniko-ligjor që mund të përbëjë shkak për mos pajisjen e këtyre shtetasve me lejet e legalizimit; nëse janë marrë tashmë vendime në kuadër të procedurave të vetëdeklarimit për legalizim të këtyre objekteve, duke sqaruar konkretisht mbi numrin e vendimeve të përjashtimit dhe ato të kualifikimit në procesin e legalizimit; si dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me këtë çështje, duke synuar në sqarimin sa më të shpejtë dhe përfundimtar të pretendimeve dhe shqetësimeve të ngritura nga komuniteti i banorëve, që do të preken nga zbatimi i këtij projekti.

²¹ Shkresat me anë të të cilave është kërkuar informacioni përkatës janë: nr.H23-2 Prot, datë 19.11.2018; nr.H23-5 Prot, datë 04.12.2018; nr.H23-5 Prot, datë 04.12.2018; nr.H23-8 Prot, datë 04.02.2019; nr. K3/H25-4 Prot, datë 06.12.2018; nr. K3/K45-4 Prot, datë 09.11.2018; nr.K3/L37-13 Prot, datë 25.02.2019;

Në përgjigje të informacionit të kërkuar, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t, Tirana – Veri, me shkresën nr. 1174/6/1 Prot, datë 21.11.2018, drejtuar Avokatit të Popullit, na bën me dije midis të tjerave se :

“... Nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, me anë të shkresës nr.8356 Prot, datë 27.09.2018, na është përcjellë planimetria e segmentit rrugor “Mbikalim pallati me Shigjeta-Rrethrotullimi Shqiponja”, vendimi i këshillit teknik të ARRSH për miratimin e projektit në formatin elektronik, si dhe na është kërkuar informacion në lidhje me ndërtimet që preken nga ky projekt.

Për sa më lart, nga drejtoria jonë u morën masat për shqyrtimin e kërkesës, dhe me anë të shkresës nr.10981/1 Prot, datë 08.11.2018, u dërgua lista e objekteve informale që preken nga projekti “Mbikalim Pallati me Shigjeta-Rrethrotullimi Shqiponja”, duke u cituar subjektet vetëdeklarues, njësia administrative dhe statusi në të cilën ndodhen praktikat e legalizimit”.

Sipas listës së dërguar ARRSH-së, nga ana e Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Tirana – Veri, me shkresën nr. 10981/1 Prot, datë 08.11.2018, rezulton se, numri i përgjithshëm i subjekteve, ndërtimet e të cilëve preken nga zbatimi i projektit, është 73, ndërsa vendimet e marra prej Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Tirana – Veri, për skualifikimin e ndërtimeve informale (përrjashtimin nga procesi i legalizimit), që preken nga zbatimi i projektit, dhe dërguar Avokatit të Popullit, është 90. Kjo situatë mospërputhjeje në shifrat e deklaruara nuk justifikohet.

Gjithashtu, me shkresën nr. 8881/4 prot, datë 11.12.2018, të Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t, drejtuar Avokatit të Popullit, konfirmohet përjashtimi nga legalizimi i 78 ndërtimeve informale, të cilat preken nga zbatimi i projektit “Mbikalimi i pallatit me shigjeta-rrethrotullimi Shqiponja”, në ndryshim me numrin e bërë të ditur prej Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Tirana – Veri, në shkresën nr. 10981/1 Prot, datë 08.11.2018. Krahas ndryshimit në numër, ka dhe një ndryshim thelbësor lidhur me emrat e pasqyruar në listat e objekteve që përjashtohen nga zbatimi i projektit “Mbikalimi i pallatit me shigjeta-rrethrotullimi Shqiponja” dhe vënë në dispozicion sipas shkresave nr. 10981/1 Prot, datë 08.11.2018, të Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Tirana – Veri, dhe shkresës nr. 8881/4 Prot, datë 11.12.2018, të Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t. Vetëm 22 emra subjektesh janë të përbashkët në shkresat e lartpërmendura, 129 emrat e tjerë janë të ndryshëm.

Në këto rrethana, bazuar dhe në informacionin e dhënë nga i njëjti organ publik, lindin pyetjet: Sa është realisht numri i ndërtimeve informale, të cilat do të preken nga zbatimi i projektit “Mbikalimi i pallatit me shigjeta-rrethrotullimi Shqiponja”. Cilit subjekt pronar/posedues i përkasin këto ndërtime? Cila është lista emërore mbi bazë të së cilës do të kryhen veprime të mëtejshme, mbi ndërtimet informale, nga ana e Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe organeve të tjera shtetërore?

Drejtorja e Përgjithshme e ALUIZNI-t, me shkresën nr. 8881/410981/1 prot, datë 11.12.2018, drejtuar Avokatit të Popullit, ka mundësuar gjithashtu edhe vënien në dispozicion të listave emërore të subjekteve, ndërtimet e të cilëve preken nga zbatimi i projektit “Mbikalimi i pallatit me shigjeta-rrethrotullimi Shqiponja”, sipas tre loteve të ndërtimit të parashikuara. Numri i përgjithshëm i ndërtimeve informale, të cilat preken nga zbatimi i projektit, sipas listave emërore për të tre lotet, është 209 dhe përkatësisht:

- **Në Lotin e parë:** Nga 66 ndërtimet që preken nga zbatimi i projektit, 40 ndërtime rezultojnë me dokumentacion pronësie dhe 26 ndërtimet e tjera, të përjashtuara nga procesi i legalizimit me vendimmarrje prej ALUIZNI-t.
- **Në Lotin e dytë:** Nga 68 ndërtimet që preken nga zbatimi i projektit, 10 ndërtime rezultojnë me dokumentacion pronësie, 3 parcela ndërtimore të kaluara në pronësi të subjektit posedues të ndërtimit informal, dhe 55 ndërtimet e tjera, në proces shqyrtimi të vetëdeklarimeve të kryera prej subjekteve posedues.
- **Në Lotin e tretë:** Nga 75 ndërtimet që preken nga zbatimi i projektit, 23 ndërtime rezultojnë me dokumentacion pronësie, 1 me leje legalizimi dhe 51 të tjera, në proces shqyrtimi të vetëdeklarimeve të kryera prej subjekteve posedues.

Pra, sipas të dhënave të konfirmuara në shkresën nr.8881/4 prot, datë 11.12.2018, të Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t, situata e ndërtimeve, të cilat preken nga zbatimi i projektit “Mbikalimi i pallatit me shigjeta- rrethrotullimi Shqiponja”, rezultojnë të jetë:

- Gjithsej, 209 ndërtime preken nga realizimi i projektit, nga të cilat, 74 të pajisura me tituj pronësie, tre troje të kaluar në pronësi subjekteve që posedojnë ndërtime informale, 26 ndërtimet e tjera të përjashtuara nga procesi i legalizimit dhe 106 në proces shqyrtimi të vetëdeklarimeve të kryera prej subjekteve posedues. Në këto të dhëna, vlen të përmendim, konfirmimin e kryer në këtë shkresë, për përjashtimin e 78 ndërtimeve informale nga procesi i legalizimit, si dhe faktin e vënies në dispozicion të Avokatit të Popullit, të 90 vendimeve të marra për përjashtimin e ndërtimeve informale nga procesi i legalizimit, konfirmuar nga ana e Autoriteti Rrugor Shtetëror, me shkresën nr. 468/2 Prot, datë 15.04.2019, drejtuar Avokatit të Popullit.

Në këtë situatë të dhënash statistikore të konfirmuara zyrtarisht prej Autoritetit Rrugor Shqiptar, Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t, apo Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Tirana – Veri, konstatohen pasaktësi, mospërputhje **dhe mungesë transparence, pasoja këto që sjellin lindjen e problemeve të ndryshme në zbatimin e projektit dhe rrjedhimisht çojnë në cënim të rëndë të interesave pasurore të subjekteve pronarë, apo posedues të pasurive të paluajtshme.**

Sipas dispozitave të Ligjit nr.9482/2006 “Për legalizimin, urbanizimin, dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, ALUIZNI, për çdo vetëdeklarim për legalizim ndërtimi informal të paraqitur nga subjektet e ndryshme pranë tij, është i detyruar të nxjerrë një vendim, qoftë ky për legalizimin e ndërtimit informal, apo edhe për përjashtimin e tij nga procesi i legalizimit.

Vendimet që i janë vënë në dispozicion Avokatit të Popullit, prej Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Tirana – Veri, kanë si objekt përjashtimin nga procesi i legalizimit të ndërtimeve informale, të cilat preken nga zbatimi i projektit “Për rehabilitimin e segmentit rrugor “Mbikalimi i pallatit me shigjeta- rrethrotullimi Shqiponja”. Ato janë nxjerrë gjatë periudhës kohore, prej datës 27.11.2018 e deri më datë 05.12.2018. Konkretisht rezultojnë të jenë, 87

vendime të nxjerra më datë 27.11.2018, 2 vendime të nxjerra më datë 03.12.2018, dhe 1 vendim i datës 05.12.2018.

Referuar këtyre vendimeve të nxjerra nga ana e Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Tirana – Veri, rezulton se ato kanë përjashtuar ndërtimet përkatëse informale nga procesi i legalizimit duke identifikuar si shkak ligjor faktin që, këto ndërtime informale janë në kushtet e parashikuara në nenin 35 dhe nenin 39, të Ligjit nr.9482/2006 “Për legalizimin, urbanizimin, dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

Ajo që bie menjëherë në sy nga përmbajtja e vendimeve është se, emërtesa e objektit të tyre është “Për kualifikimin e ndërtimit informal”, pavarësisht faktit se në dispozitiv është vendosur për përjashtimin e ndërtimit informal të vetëdeklaruar për legalizim, nga procesi i legalizimit. Këto vendime në konceptimin strukturor janë të një tipi format standard, me rubrika të përcaktuara standarde dhe të njëjta për çdo vendim. Të vetmit elementë që ndryshojnë në to është pjesa e gjeneraliteteve të subjektit vetëdeklarues dhe vendndodhja e ndërtimit informal, në njësitë përkatëse administrative, të Bashkisë Tiranë.

Në bazë të parashikimeve të nenit 99, të Kodit të Procedurave Administrative, ku përcaktohen kërkesat e formës së aktit administrativ të shkruar, konstatohet se vendimet për përjashtimin e ndërtimeve informale nga procesi i legalizimit, të nxjerra nga ana e Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Tirana – Veri, nuk i kanë respektuar këto kërkesa, pasi kanë një sërë mangësish. Më konkretisht, këtyre akteve administrative që sjellin pasoja për palët në momentin që ato hyjnë në fuqi, u mungon baza e plotë ligjore mbi të cilën është mbështetur procedura administrative e zhvilluar. Mënyra e konceptimit fragmentar me rubrika ku gjenden përcaktime tërësisht telegrafike, identifikon edhe mungesë të arsytimit të vendimit (aktit administrativ), pasi mungon shpjegimi i situatës faktike mbi bazë të së cilës janë nxjerrë këto akte. Ndërkohë është konstatuar që, këto vendime kanë edhe elementë të tjerë të munguar apo të mangët, në kuptim të ligjit.²²

Në asnjë vendim të nxjerrë prej Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Tirana – Veri, për përjashtimin nga legalizimi të ndërtimeve informale, nuk jepen të dhënat e akteve të administruara në cilësinë e provave, të cilat provojnë qënien e tyre në kushtet e parashikuara në nenin 35, apo të nenit 39, të Ligjit nr.9482/2006 “Për legalizimin, urbanizimin, dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

Në këto rrethana, vendimet e sipërcituara që i janë vënë në dispozicion Avokatit të Popullit, prej Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Tirana – Veri, për përjashtimin nga legalizimi të ndërtimeve informale, konstatojmë se kanë elementë paligjshmërie në kuptim të përcaktimit të bërë në nenin 109/c të Kodit të Procedurës Administrative, për paligjshmërinë e aktit administrativ.

Ndërkohë, nga të 73 subjektet e treguara në shkresën nr. 10981/1 Prot, datë 08.11.2018, të Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Tirana – Veri, 22 prej tyre janë pajisur përgjatë viteve 2011 – 2017, me leje legalizimi për ndërtimet e tyre informale, ndërtime të cilat preken nga zbatimi i projektit “Mbikalimi i pallatit me shigjeta- rrethrotullimi Shqiponja”.

²² Avokati i Popullit po kryen një hetim të thelluar ndërkohë për këtë çështje.

Po ashtu, nga informacioni i administruar prej ARRSH-së, sipas shkresës 10981/1 prot, datë 08.11.2018, të Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Tirana – Veri, si dhe informacionit të administruar prej Avokatit të Popullit, për çështjen e përjashtimit nga procesi i legalizimit të ndërtimeve informale, që preken nga zbatimi i projektit “Mbikalimi i pallatit me shigjeta-rrethrotullimi Shqiponja”, rezulton se, veprimtaria e organeve shtetërore në fjalë, mbart parregullsi dhe paligjshmëri me pasoja për të drejtat e ligjshme të subjekteve, ndërtimet e vetëdeklaruarat të cilëve janë përjashtuar me vendimin përkatës të ALUIZNI-t, nga procesi i legalizimit.

Mbi bazë të informacionit të dhënë prej Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Tirana – Veri, sipas shkresës 10981/1 Prot, datë 08.11.2018, ARRSH-ja, është nxjerrë Urdhëri nr.10459 prot, datë 20.11.2018, “Për ngritjen e grupit të punës për shpronësimet për interes publik”.

Veprimtaria e Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Tirana – Veri, në procesin e shqyrtimit të vetëdeklarimeve të kryera prej subjekteve të përmendura në shkresën 10981/1 prot, datë 08.11.2018, drejtuar ARRSH-s, apo gjithë subjekteve të tjerë, të cilët nuk përmenden në këtë shkresë, është në cënim të së drejtës themelore të njeriut për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.

Një nga shkaqet e cënimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, është edhe mospërfundimi i procesit administrativ, të shqyrtimit të të gjithë vetëdeklarimeve në afatin ligjor të parashikuar, në nenin 49, të Ligjit nr. 8454, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Nga ana tjetër duhet theksuar se, vendimmarrja e ALUIZNI-t, pavarësisht kohës së paraqitjes së vetëdeklarimeve për legalizim pranë këtij organi nga subjektet e interesuara, është kushtëzuar **krejtësisht në mënyrë të pajustificuar ligjore**, nga miratimi i *Planit të Përgjithshëm Vendor, i Bashkisë, Tiranë, (viti 2017)*, si dhe në vazhdim nga miratimi i projektit “Mbikalimi i pallatit me shigjeta-rrethrotullimi Shqiponja”, (viti 2018). Duhet evidentuar se, në momentin që subjektet e interesuara kanë paraqitur vetëdeklarimin për legalizim, nuk ka patur projekte të miratuara për zonën e Astirit.

Mosrespektimi i detyrimit ligjor prej Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Tirana – Veri, për përfundimin e procedimit administrativ të shqyrtimit të vetëdeklarimeve, në afatet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, justifikohet prej Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t, në shkresën nr.8881/4 prot, datë 11.12.2018, ku thuhet se:

“Shkaqet që çojnë në pezullimin ose vonesa të procesit për zonën në fjalë lidhen kryesisht me:

Mangësi dhe vonesa të procedurave të rregjistrimit dhe të hedhjes në sistem të zonave kadastrale, të cilat krijojnë pamundësi në përcaktimin e saktë të statusit juridik të pronës. (Zona kadastrale 3866 është e pa azhornuar dhe mbart pasaktësi dhe mbivendosje të pasurive). PPV (autori-Plani i Përgjithshëm Vendor) i Bashkisë, Tiranë, 2017, parashikon zhvillime të larta për gjithë territorin përgjatë aksit rrugor Unaza e Re, me lartësi maksimale të lejuar 8-9 kat. Ky fakt, si dhe raporti i pasurive në tokë me pronar në rangun e mbi 50% të pronave, përbën pengesë në konkludimin e legalizimeve në kuadër të nenit 35 të Ligjit nr.9482, i ndryshuar, si dhe VKM-së 280/2015, i ndryshuar, ku citojmë “Ndërtimet pa leje të ngritura mbi troje private të të tretëve, kur planet e përgjithshme vendore parashikojnë ndërtime mbi 6 kate nga niveli zero, nuk i nënshtrohen procedurave për legalizim”.

Vetëdeklarimet për legalizim të paraqitura nga subjektet e interesuara, posedues të ndërtimeve informale, që përfshihen në gjurmën e projektit në fjalë janë kryer gjatë periudhës së viteve 2005-2006, kohë në të cilën nuk ka pasur të miratuar një plan të përgjithshëm vendor, si dhe një projekt të miratuar zhvillimor në këtë zonë. Sikurse rezulton, Plani i Përgjithshëm Vendor, i Bashkisë Tiranë është miratuar në vitin 2017, ndërsa leja zhvillimore, është miratuar për këtë zonë në fund të vitit 2018, gjë që do të thotë se nuk ka asnjë lloj justifikimi ligjor për mosdaljen me vendim kualifikimi, ose përjashtimi nga procesi i legalizimit nga ana e ALUIZNI-t, përgjatë kësaj periudhe të gjatë kohore.

Fakti që, me shkresën nr. 10981/1 Prot, datë 08.11.2018, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t, Tirana – Veri, konfirmon lëshimin e lejeve të legalizimit për 22 ndërtime, përgjatë viteve 2011 – 2017, vërteton se, **Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t, Tirana – Veri, ka kryer në mënyrë selektive legalizimin e ndërtimeve informale edhe pse të gjitha ndërtimet informale kanë qenë në të njëjtën situatë juridike para miratimit të PPV-s për Bashkinë, Tiranë apo Vendimit nr.01, datë 20.11.2018, të Këshillit Kombëtar të Territorit.** Nëse do ekzistonin pengesa, atëhere, kjo Drejtori, nuk do të mund të nxirrte asnjë leje legalizimi për ndërtimet informale në zonën e Astirit, ndërkohë që janë nxjerrë 22 të tilla. Nisur nga konfirmimi i dhënë prej Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t, se janë 74 ndërtime me dokumentacion pronësie, të cilat preken nga zbatimi i projektit, na bënë të besojmë se, numri i përgjithshëm i lejeve të legalizimit të lëshuara në vite prej kësaj Drejtorie, është më i lartë se 22 leje legalizimi të pranuar të dhëna.

Pra, veprimtaria e Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Tirana – Veri, në procesin e shqyrtimit të vetëdeklarimeve për ndërtimet informale, të cilat preken nga zbatimi i projektit në fjalë, rezulton të jetë kryer me dy standarde, megjithëse situata juridike e ndërtimeve informale që ndodhen në këtë zonë ka qenë e njëjtë, në kohën e vetëdeklarimit të tyre për legalizim. Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t, Tirana – Veri, ka miratuar lëshimin e lejes së legalizimit vetëm për 22 ndërtime, ndërkohë që nuk ka pasur asnjë shkak të përligjur për mospërfundimin e shqyrtimit të të gjithë vetëdeklarimeve për ndërtimet informale, që preken nga zbatimi i projektit të miratuar me Vendimin nr.01, datë 20.11.2018, të Këshillit Kombëtar të Territorit.

E gjithë kjo problematikë është konstatuar ndërkohë që, në zonën e gjurmës së zbatimit të projektit “*Mbikalimi i pallatit me shigjeta- rrethrotullimi Shqiponja*”, situata e subjekteve që preken në pronësitë e tyre rezulton të jetë, si më poshtë:

- Subjekte (individë) me ndërtime të ligjshëm, të kryera mbi bazën e lejeve përkatëse të ndërtimit. Kjo gjendje do të thotë se kemi të bëjmë me një ndërtim të ligjshëm, pronë e ligjshme e subjektit që e ka ndërtuar atë, në një sipërfaqe trualli funksional në pronësi të ligjshme gjithashtu, të po këtij subjekti. Në rast cënimi të kësaj pronësie të ligjshme për shkak të zbatimit të projektit “*Mbikalimi i pallatit me shigjeta- rrethrotullimi Shqiponja*”, pronari i ligjshëm duhet të shpronësohet nëpërmjet një procesi të drejtë shpronësimi, si për ndërtimin e ligjshëm, ashtu edhe për truallin funksional në të cilin ngrihet ky ndërtim.
- Subjekte (individë) me ndërtime informale, të kryera pa leje ndërtimi, por të ngritura në sipërfaqe trualli në pronësi të ligjshme të subjektit. Këto subjekte kanë patur mundësi që të paraqesin vetëdeklarimet e tyre për legalizimin e ndërtimit informal, brenda afateve të

parashikuara në dispozitat e Ligjit nr.9482/2006 *“Për legalizimin, urbanizimin, dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”*, i ndryshuar. Në rast se ata e kanë paraqitur këtë vetëdeklarim brenda afatit të përcaktuar ligjor, ALUIZNI do të shqyrtojë vetëm procesin e legalizimit të ndërtimit informal, pasi trualli funksional i ndërtimit është në pronësi të ligjshme të subjektit. Nëse ndërtimi informal është legalizuar me vendim të ALUIZNI-t, atëherë në rast cënimi të kësaj pronësie të ligjshme, për shkak të zbatimit të projektit *“Mbikalimi i pallatit me shigjeta- rrethrotullimi Shqiponja”*, pronari i ligjshëm duhet të shpronësohet nëpërmjet një procesi të drejtë shpronësimi, si për ndërtimin e tij tashmë të ligjshëm, ashtu edhe për truallin funksional në të cilin ngrihet ky ndërtim.

- Subjekte (individë), që kanë vendime të ish Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, për kthimin e sipërfaqeve të tokës, të ndodhura në këtë zonë. Kjo do të thotë se në rast se sipërfaqja e tokës është e lirë dhe ndërkohë subjektet e interesuara e kanë regjistruar këtë akt kalimi pronësie në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtëshme, atëherë këto subjekte janë në disponim të plotë, të pasurisë së tyre. Në rast cënimi të kësaj pronësie të ligjshme për shkak të zbatimit të projektit *“Mbikalimi i pallatit me shigjeta- rrethrotullimi Shqiponja”*, pronari/pronarët e ligjshëm duhet të shpronësohen nëpërmjet një procesi të drejtë shpronësimi, për atë që ky projekt cënon, nëse cënohet një pjesë e pronës dhe jo e gjitha. Ndërkohë për pjesën tjetër të pronës, të mbetur të pacënuar subjekti pronar mund të kërkojë dëmshpërblim për zhvleftësimin që mund t'i ndodhë asaj për shkak të shpronësimit të pjesës tjetër të pronës. Në rast se kjo pronë rezulton e zënë me ndërtime të kundërligjshme që nuk i janë nënshtruar procesit të legalizimit, atëherë në rast cënimi të saj për shkak të zbatimit të projektit, pronari/pronarët e ligjshëm duhet të shpronësohen. Nëse ndërtimet e kundërligjshme janë vetëdeklaruar nga poseduesit e tyre për legalizim pranë ALUIZNI-t, dhe ky i fundit ka marrë vendim për legalizimin e tyre bashkë me truallin funksional, atëherë sipas legjislacionit në fuqi, ALUIZNI do të vazhdojë me procedurat e dëmshpërblimit të këtyre pronarëve, sipas përcaktimeve të Ligjit nr.9482/2006 *“Për legalizimin, urbanizimin, dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”*, i ndryshuar.
- Subjekte (individë) që kanë paraqitur vetëdeklarimin për legalizim të ndërtimeve të tyre informale pranë ALUIZNI-t, ende në process shqyrtimi nga ana e këtij të fundit dhe subjekte që kanë paraqitur vetëdeklarimin për legalizim të ndërtimeve të tyre informale pranë ALUIZNI-t, për të cilët është nxjerrë vendim për leje legalizimi. Kur subjektet janë ende në proces legalizimi, atëherë nuk mund të merret asnjë vendim nga asnjë organ tjetër shtetëror që ka të bëjë me, apo që prek, cënon, ndërtimin informal dhe truallin funksional të tij, pa nxjerrë ALUIZNI (sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës), një vendim përfundimtar për këtë rast. Qoftë ky vendim për legalizimin e ndërtimit informal, apo për përjashtimin e tij nga procesi i legalizimit. Ligji nr.9482/2006 *“Për legalizimin, urbanizimin, dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”*, i ndryshuar, ka përcaktuar nëdispozitat e tij (nenet 35 dhe 39 të tij), rastet kur ndërtimet informale nuk mund të legalizohen. Në rast se ALUIZNI ka nxjerrë një vendim për përjashtimin nga legalizimi të ndërtimit informal, atëherë mbi bazën e legjislacionit në fuqi, ai cilësohet në kushtet e një ndërtimi të kundërligjshëm dhe është objekt prishjeje pa kundërshpërblim. Në rast se kemi të bëjmë me një ndërtim për të cilin është nxjerrë leja e legalizimit, atëherë në rast cënimi të kësaj pronësie të ligjshme për shkak të zbatimit të projektit *“Mbikalimi i pallatit me*

shigjeta- rrethrotullimi Shqiponja”, pronari i ligjshëm duhet të shpronësohet nëpërmjet një procesi të drejtë shpronësimi.

- Subjekte (individë) me ndërtime informale që nuk disponojnë asnjë dokumentacion dhe që nuk kanë paraqitur vetëdeklarime për legalizim. Mbi bazën e legjislacionit në fuqi ky ndërtim cilësohet në kushtet e një ndërtimi të kundërligjshëm dhe është objekt prishjeje pa kundërshtpërblim.

Në ankesat e shqyrtuara prej Institucionit të Avokatit të Popullit, është konstatuar, se, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t, Tirana – Veri, në rastin e kalimit në pronësi të parcelës ndërtimore në favor të poseduesit të ndërtimit informal B.N., sipas VKM nr.125, datë 17.02.2010, apo K.H. sipas VKM-së nr.646, datë 28.07.2010, nuk ka vijuar zhvillimin e procedurës së mëtejshme, për nënshkrimin e kontratës së shitjes të kësaj parcele, e më tej të lëshimit të lejes së legalizimit për ndërtimin informal.

Kjo procedurë, nuk është përfunduar nga ana e Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Tirana – Veri, pa asnjë shkak të justifikuar ligjërisht edhe pse ankuesi ka kërkuar me këmbëngulje zhvillimin e saj. Zhvillimin e kësaj procedure në njerin prej rasteve të përmendura e ka kërkuar dhe Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t, me shkresën nr.8939 prot, datë 12.11.2018, dërguar Drejtorisë së ALUIZNI-t, Tirana - Veri.

6. Bashkëpunimi i Bashkisë Tiranë, në proces.

Në procesin e shqyrtimit të disa ankesave të paraqitura nga disa banorë, ndërtimet e të cilëve do të pretehej se mund të preken nga realizimi i projektit *“Rehabilitimi i segmentit rrugor “Mbikalimi i pallatit me shigjeta – rrethrotullimi “Shqiponja”*, është kërkuar me shkresën nr. K3/K45-3 Prot, datë 09.11.2018, informacion dhe shpjegime Bashkisë, Tiranë, lidhur me:

a) nëse ka pasur komunikime dhe kërkesa zyrtare nga institucione të tjera shtetërore në kuadër të këtij projekti dhe si po trajtohen në vijim nga ana e Bashkisë, Tiranë pretendimet dhe shqetësimet e banorëve në zonën e Astirit;

b) nëse janë konsultuar paraprakisht dhe informuar banorët e zonës së Astirit mbi projektin që do të zbatohet;

c) nëse janë evidentuar familjet që mund të preken nga ky projekt dhe prishja e banesave apo objekteve të tjera në posedim të tyre dhe sa është numri i shtetasve dhe pasurive që mund të preken nga zbatimi i këtij projekti;

ç) cilat janë programet konkrete të mbështetjes që ofron Bashkia Tiranë për familjet që mund të ngelen pa shtëpi banimi dhe nëse gjykoni se programi i bonusit të qerasë për një periudhë një vjeçare, me të drejtë rinovimi, ofron një garanci reale dhe mbështetje efektive për këto familje;

d) cili është organi dhe akti me të cilin është miratuar ky projekt, sa është vlera e tij dhe nëse mund të ndiqen paraprakisht procedurat e shpronësimit të këtyre shtetasve, ashtu siç parashikohet në Ligjin Nr.8561 datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;

dh)sa është vlera totale e shpronësimeve dhe cilat janë shkaqet që nuk iniciohen paraprakisht këto procedura shpronësimi para se të ndërhyhet forcërisht ndaj objekteve të banimit dhe shërbimit;

e) si dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me këtë çështje, duke synuar në sqarimin sa më të shpejtë dhe përfundimtar të pretendimeve dhe shqetësimeve të ngritura prej ditësh nga komuniteti i banorëve që do të preken nga zbatimi i këtij projekti.

Në përgjigje të kërkesës, Bashkia Tiranë, me shkresën nr.42163/1 Prot, datë 22.11.2018, ka informuar Avokatin e Popullit, rreth situatës së çështjes, duke bërë me dije se :

“Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale mbështetur në shkresën nr. 9375, datë 25.10.2018, të Autoritetit Rrugor Shqiptar, i cili kërkon bashkëpunim për kryerjen e vlerësimit social ekonomik të familjeve të cilat preken nga zbatimi i projektit, segmenti rrugor “Mbikalimi i pallatit me shigjeta – rrethrotullimi “Shqiponja”, dhe kryerjen e verifikimit në terren të gjendjes ekzistuese të familjeve, të cilat do të përfshihen në programet sociale të strehimit, si dhe urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr.40195, datë 29.10.2018, ngriti grupin e punës për vlerësimin e situatës në terren, ...

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale ... realizoi vlerësimin social-ekonomik në familjet e prekura të segmentit rrugor “Mbikalimi i pallatit me shigjeta – rrethrotullimi “Shqiponja”. Zona e zbatimit të projektit përfshin Njësitë Administrative nr.6, 7, 11 dhe Kashar.

Vlerësimet social-ekonomike në terren janë realizuar nga grupet e punës të përbërë nga punonjës social/psikolog, administrator shoqëror, urbanist të njësisë administrative përkatëse, përgjegjësi dhe specialist nga Drejtoria e Strehimit Social. Grupi ka pasur për qëllim evidentimin e situatës reale të kushteve social ekonomike dhe kushteve të strehimit të familjeve që preken nga projekti. Këto të dhëna janë përpunuar në një “database” të vetëm dhe përcjellë ARRSH, për të vijuar koordinimin e proceseve në vijim të këtij projekti.

Nga informacionet e mbledhura nga qytetarët u konstatua se jetesa në zonën e prekur nga projekti sigurohej nga të ardhurat nga vetëpunësimi në sektorin privat, qiratë nga biznesi, të ardhura nga pensioni dhe emigracioni.

- | | |
|---|-----|
| - Numri i familjeve të vlerësuara sipas formularëve | 141 |
| - Numri i bizneseve të vlerësuara sipas formularëve | 122 |
| - Numri i të sëmurëve kronik | 8 |

- Numri i personave me status invaliditeti	8
- Numri i të punësuarve	35
- Numri i të vetëpunësuarve	7
- Numri i pensionistëve	42
- Numri i familjeve që jetojnë me të ardhura nga biznesi	8
- Numri i familjeve që jetojnë me të ardhura nga emigracioni	10
- Familje që kanë refuzuar të japin informacion për plotësimin e formularëve, me pretendimin se kishin përfituar banesën me akt normative dhe nuk janë subjekt i këtij projekti	30

Sqarojmë se, këto të dhëna kanë dalë në bazë të vetëdeklarimeve të qytetarëve...”

Informacioni dhe shpjegimet e dhëna prej Bashkisë Tiranë, ndonëse më të plotat e paraqitura, në kuadër të këtij hetimi administrativ, përsëri nuk kanë sjellë të tërë informacionin e nevojshëm për të trajtuar problemin në përputhje me ligjin.

Bashkia Tiranë, nuk jep informacion rreth numrit të ndërtimeve të cilat preken nga zbatimi i projektit “Mbikalimi i pallatit me shigjeta – rrethrotullimi “Shqiponja” dhe as për numrin e familjeve dhe shtetasve, të cilët rrezikojnë të mbetën pa strehë.

Bashkia Tiranë, nuk tregon kapacitetet konkrete që ajo disponon për familjet që rrezikojnë të mbetën pa strehë. Gjithashtu, ky institucion nuk shprehet rreth garancive reale që do të mund të ofronte programet sociale të strehimit që ofrohen aktualisht nga Bashkia Tiranë.

Ndër të tjera, megjithëse një konkluzion i kuptueshëm nga sa është trajtuar në pjesët e tjera të këtij raporti, Bashkia Tiranë nuk ka dhënë informacion apo nuk ka vënë në dispozicion kopje të aktit administrativ, për miratimin e projektit “Mbikalimi i pallatit me shigjeta – rrethrotullimi “Shqiponja”. Kjo mungesë informimi konstatohet edhe për pyetje të tjera të adresuara nga ana jonë në shkresën nr.42163/1 Prot, datë 22.11.2018, të sipërcituar.

Është e vërtetë se Bashkia Tiranë ka ndërmarrë një proces të vetin për vlerësimin social ekonomik të familjeve, të cilat preken nga zbatimi i projektit, segmenti rrugor “Mbikalimi i pallatit me shigjeta – rrethrotullimi “Shqiponja”, por ky proces është i pjesshëm dhe i mangët, referuar qasjes së duhur ndaj situatës potenciale të dëbimit me forcë, të të gjitha familjeve që preken nga zbatimi i këtij projekti. Numri i objekteve të bëra me dije mediatikisht se do të preken, ai atyre që janë prishur tashmë ose që do të prishen, identifikon një komunitet banorësh të konsiderueshëm në numër, që duhet të zhvendoset nga kjo zonë për shkak të ndërtimit të një vepre publike.

Sikurse kemi theksuar në qëndrimet tona zyrtare për trajtimin e situatave të dëbimit me forcë, gjithmonë dhe paraprakisht nevojitet kryerja e një studimi të gjendjes së familjeve që preken në pronësitë e tyre nga zbatimi i projektit për ndërtimin e veprës publike, sa i takon përbërjes së tyre, mundësive financiare, trajtimit të mundshëm me strehim dhe çështjeve të tjera sociale, që lidhen me nivelin e jetesës në vazhdim. Kjo qasje duhet të vijë në përputhje me sa përcaktohet në pikën 11, të nenit 2 dhe nenin 6, të Ligjit “Për strehimin social”, si dhe të harmonizohet me të gjitha parimet dhe standardet ndërkombëtare të trajtimit të rasteve të dëbimit me force, të parashikuara në akte të rëndësishëm të OKB-së, Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe në jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Verifikimi në terren është një element i vlefshëm i këtij procesi, i cili duhet të alternohet me informacionin e marrë në rrugë zyrtare nga të gjitha organet apo institucionet e tjera shtetërore që disponojnë informacion të vlefshëm dhe të nevojshëm për procesin.

Kjo situatë nuk prek drejtëpërdrejtë vetëm të drejtën për strehim, por në kushtet kur ajo ndodh e pastudjuar dhe në mungesë të konsultimit me komunitetin që do të dëbohet/zhvendoset, çënon të drejtën për jetën familjare, si dhe të drejtën për jetën.

7. Roli i Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) dhe Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit (IMT), në Bashkinë Tiranë.

Në një proces normal të kryerjes së një punimi infrastrukturor dhe të zbatimit të një leje ndërtimi, të miratuar me vendimmarrjen e organit kompetent, për ndërtimin e një vepre publike, nevojitet mundësimi i lirimit dhe përgatitja e sheshit të ndërtimit për fillimin e punimeve.

Në rastin e mundshëm të zbatimit të vendimit përkatës të Këshillit Kombëtar të Territorit, ku miratohet Leja e Zhvillimit për Objektivin, “Rehabilitim i Segmentit Rrugor Mbikalimi Pallati me Shigjeta – Rrethrotullimi Shqiponja”, Loti 1, Loti 2, Loti 3, Bashkia Tiranë”, me subjekt zhvillues Autoritetin Rrugor Shqiptar”, ndërhyrja e pritshme për mundësimin e lirimit të sheshit të ndërtimit, duhet të realizohet nëpërmjet veprimeve të ndërmarra nga ana e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, apo edhe të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, në Bashkinë Tiranë.

Gjurma e përcaktuar nga projekti i miratuar për zbatim me anë të lejes së ndërtimit, pritet të çënojë prona që, në statusin e tyre aktual mund të jenë:

- Ndërtime të ligjshme, të ndërtuara me leje ndërtimi dhe të regjistruara në ZVRPP, Tiranë, në pronësi të subjekteve shtetërore, apo të subjekteve private.
- Ndërtime të ligjshme, të ndërtuara me leje ndërtimi ende të paregjistruara në ZVRPP, Tiranë, në pronësi të subjekteve shtetërore, apo të subjekteve private.
- Ndërtime/objekte informale të vetëdeklaruar për legalizim, pranë ALUIZNI-t.
- Ndërtime/objekte informale të padeklaruar për legalizim, pranë ALUIZNI-t.
- Pasuri të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991, me truallin funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, nga subjekti që i disponon ato.

Në logjikën e ligjit, një akt administrativ fillon të sjellë pasoja juridike pas ezaurimit të procedurave të nevojshme ligjore për futjen në fuqi të tij dhe me njoftimin e përmbajtjes së tij, palëve të cilave ai iu drejtohet, apo që preken nga ky akt.²³

Rrjedhimisht zbatimi i projektit, “Rehabilitim i Segmentit Rrugor Mbikalimi Pallati me Shigjeta – Rrethrotullimi Shqiponja”, Loti 1, Loti 2, Loti 3, Bashkia Tiranë”, mund të fillonte vetëm pasi KKT-ja të nxirrte vendimin e saj për miratimin e Lejes së Ndërtimit për Objektivin, “Rehabilitim i Segmentit Rrugor Mbikalimi Pallati me Shigjeta – Rrethrotullimi Shqiponja”, Loti 1, Loti 2, Loti 3, Bashkia Tiranë”, me subjekt zhvillues Autoritetin Rrugor Shqiptar”.

²³ Neni 104, i Kodit të Procedurave Administrative.

Në këtë moment ARRSH-ja si subjekt zhvillues, do të mund t'i kërkonte IKMT-së apo IMT-së në Bashkinë Tiranë, ushtrimin e kompetencave ligjore për lirimin e sheshit të ndërtimit, që përkon me gjurmën e zbatimit të projektit të miratuar, nga ndërtimet e çfarëdo statusi ekzistues qofshin ato, të cilat preken nga zbatimi i këtij projekti.

Çfarë ka rezultuar gjatë shqyrtimit të problematikave nga ana jonë në zonën e Astirit?

- Sipas shkresave të IKMT-së me nr.4483/2 datë 27.11.2018 dhe nr.4726/1 datë 14.12.2018, drejtuar Avokatit të Popullit, në to thuhet përkatësisht se:

“Me shkresën me nr.9765 prot, datë 5.11.2018, protokolluar pranë institucionit tone me nr.4287 prot, datë 6.11.2018, Autoriteti Rrugor Shqiptar kërkon mbështetje për lirimin e sheshit të ndërtimit nga objektet pa leje, për realizimin e projektit të Unazës së Madhe, segmenti rrugor “Mbikalimi pallati me shigjeta –rrethrotullimi Shqiponja”. Deri në këto momente jemi në fazë verifikimi të situatës në terren, ndërsa në lidhje me prishjen e “Shqiponjës”, të ndodhur në rrethrotullim, ju informojmë se IKMT-ja nuk ka mbajtur procedurë ligjore dhe nuk ka bërë asnjë veprim për heqjen e këtij monumenti.

... rezulton se IKMT ka verifikuar dhe kontrolluar në terren në këtë zonë vetëm në datën 3 Dhjetor 2018, dhe aktualisht nuk ka proceduar me vendimmarrje administrative për zbatimin e këtij projekti.” (Shkresa e datës 14.12.2018).

“Në lidhje me këtë projekt, ne jemi njohur me shkresën me nr.9765 prot, datë 5.11.2018, protokolluar pranë institucionit tonë me nr.4287 prot, datë 6.11.2018, me anë të së cilës, Autoriteti Rrugor Shqiptar kërkon mbështetje për lirimin e sheshit të ndërtimit nga objektet pa leje, për realizimin e projektit të Unazës së Madhe, segmenti rrugor “Mbikalimi pallati me shigjeta –rrethrotullimi Shqiponja”, ndërsa leja zhvillimore në formë zyrtare nuk është depozituar pranë nesh” (Shkresa e datës 27.11.2018).

Pra, konstatohet se në rrugë zyrtare, fillimisht në datën 27.11.2018, ARRSH-ja i ka kërkuar IKMT-së, mbështetje për lirimin e sheshit të ndërtimit nga objektet pa leje, për realizimin e projektit të Unazës së Madhe, segmenti rrugor “Mbikalimi pallati me shigjeta –rrethrotullimi Shqiponja”, kur leja e ndërtimit nuk është miratuar ende nga ana e KKT-së. Më pas, në datën 14.12.2018, ARRSHN-ja kërkon të njëjtën gjë nga ana e IKMT-së, por pa i përcjellë zyrtarisht lejen e ndërtimit mbi bazën e së cilës do të kryhen punimet.

Sipas shkresës nr.1062 prot, datë 24.01.2019, të IMT në Bashkinë Tiranë, drejtuar Avokatit të Popullit, konfirmohet shprehimisht se:

“Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Bashkisë Tiranë, nuk ka dijeni zyrtare për miratimin e këtij projekti apo leje zhvillimore në segmentin nga “Mbikalimi i pallatit me shigjeta –rrethrotullimi “Shqiponja”.

Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Bashkisë Tiranë, nuk disponon korrespondencë zyrtare me Autoritetin Rrugor Shqiptar lidhur me kërkesë për lirim sheshi të ndërtimit në kuadrin e zhvillimit të këtij projekti.

Nga ana e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, nuk është marrë pjesë në ndërhyrjen për prishje të objekteve që pengojnë zhvillimin e këtij projekti”.

Pra, së paku deri në datën 24.01.2019, nga ana e IMT-së në Bashkinë Tiranë, pohohet se nuk është marrë pjesë dhe për rrjedhojë nuk është mbajtur asnjë procedurë për prishje të objekteve, të ndodhura në gjurmën e projektit që do të zbatohet për ndërtimin e segmentit rrugor, “Mbikalimi pallati me shigjeta –rrethrotullimi Shqiponja”.

Me të drejtë lind pyetja: A ka ushtruar kompetencat e tij ky organ, kur Tirana ishte përfshirë nga protestat dhe kur po shkatërrohej prona publike, me ndërhyrje të pa mbështetura me leje ndërtimi të miratuar, fakt që për të ishte evident?

- Në institucionin e Avokatit të Popullit, ka disa ankesa individuale të paraqitura nga individë që kanë patur, apo kanë banesa në zonën e Astirit, të cilëve ose iu janë prishur tashmë, ose për të cilat janë dërguar njoftimet për prishje.
- E tillë është ankesa e shtetasit B.N. (ankesa me nr.201802399), i cili është ankuar për prishjen e objektit të tij informal në datën 4.12.2018, por pa patur dijeni për përkatësinë institucionale të personave që kanë ndërhyrë për prishjen e këtij ndërtimi. Nga hetimi administrativ i kësaj çështjeje ka rezultuar ndër të tjera se, as IKMT-ja, por as edhe IMT-ja në Bashkinë Tiranë, nuk konfirmojnë të kenë ndërhyrë dhe nuk kanë dijeni për prishjen e objektit, në disponim të shtetasit B.N.

Nga ana e IKMT-së, ky qëndrim është mbajtur në shkresën nr.4726/1 datë 14.12.2018, drejtuar Avokatit të Popullit, ku thuhet shprehimisht se: *“Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit nuk ka informacion zyrtar në lidhje me veprimet administrative të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë dhe as për prishjen e ndërtimit informal të z. B.N”*.

Kurse nga ana e IMT-së në Bashkinë Tiranë, na është konfirmuar me shkresën nr.1058/1 datë 28.02.2019, drejtuar Avokatit të Popullit, se: *“Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë nuk ka dijeni për prishjen e këtij objekti”*.

- Në ankesën e shtetasit A.Ç (ankesa nr.201802208), ku shprehet shqetësimi për mungesë informacioni dhe njoftimi zyrtar në lidhje me projektin e zgjerimit të segmentit rrugor të unazës së Madhe të Tiranës, në zonën e Astirit, ngrihet edhe shqetësimi i njoftimit paraprak verbal për prishjen e objekteve në kuadër të zbatimit të projektit.

Pas kërkesës së përsëritur për shpjegime, drejtuar IKMT-së lidhur me këtë ankesë, rezulton që me shkresën nr.4472/1 prot, datë 23.11.2018, të këtij organi, na është dhënë përgjigja se:

“Me shkresën me nr.9765 prot, datë 5.11.2018, protokolluar pranë institucionit tonë me nr.4287 prot, datë 6.11.2018, Autoriteti Rrugor Shqiptar kërkon mbështetje nga ana jonë për lirimin e sheshit të ndërtimit nga objektet pa leje, për realizimin e projektit të Unazës së Madhe, segmenti rrugor “Mbikalimi pallati me shigjeta-rrethrotullimi shqiponja”.

Deri në këto momente, nga ana e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit nuk është ndërmarrë asnjë veprim procedural ligjor, deri në shprehjen e institucioneve të ALUIZNI-t dhe ARRSH për statusin juridik të objekteve, të cilat preken nga gjurma e këtij projekti”.

Ndërkohë me shkresën tjetër të IKMT-së, me nr.34 datë 3.01.2019, drejtuar Avokatit të Popullit, konfirmohet se ka filluar identifikimi i objekteve të ndërtuara pa leje, në terren. Sikurse ky organ

shprehet në këtë shkresë; *“Pas verifikimit dhe evindetimit të tyre, si edhe në vijim të njoftimeve për vendimet për “skualifikimin e objekteve nga procesi i legalizimit”, ardhur pranë nesh nga institucioni i ALUIZNI-t, deri tani janë mbajtur dhe përfunduar procedurat ligjore në emër të subjekteve”,* (bashkëngjitur shkresa nr.306 prot, datë 7.12.2018 e IKMT, dega Tiranë, ku jepet informacion për mbajtje proces-verbal konstatimi për 6 subjekte). Në vazhdim të kësaj praktike janë bashkëngjitur njoftimet për vendimet për prishje objekti dhe për dënimin me gjobë, për këto subjekte.

- Në ankesën e shtetasit H.H (ankesa me nr.201802400), kundërshtohen veprimet e punonjësve të IKMT-së dhe IMT në Bashkinë Tiranë, të cilët sipas ankesës, kanë prishur në datën 4.12.2018, një ndërtim në posedim të djalit të tij, shtetasit K.H. Ankesa shpreh shqetësimin se, prishja është kryer nga inspektorët e këtyre organeve pa kryer asnjë njoftim zyrtar më parë, si dhe duke mos i dhënë mundësi ankuesit të hiqte orenditë nga shtëpia.

Në përgjigjen e dhënë nga ana e IMT në Bashkinë Tiranë për këtë ankesë, me anë të shkresës nr.21059/1 datë 28.02.2019, drejtuar Avokatit të Popullit, thuhet ndër të tjera shprehimisht se: *“Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë nuk ka dijeni për prishjen e këtij objekti”.*

Ndërkohë në përgjigjen e dhënë me shkresën nr.4725/1 datë 14.12.2018, nga ana e IKMT-së, lidhur me këtë ankesë, sqarohet shprehimisht se: *“Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit nuk ka informacion zyrtar në lidhje me veprimet administrative të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, dhe as për prishjen e ndërtimit informal të familjes H. Ndërkohë që IKMT-ja nuk ka ndërmarrë veprime administrative në lidhje me këtë subjekt. Nga datat e cituara në shkresën tuaj, rezulton se IKMT ka verifikuar dhe kontrolluar në terren në këtë zonë vetëm në datën 3 Dhjetor 2018, dhe aktualisht nuk ka proceduar me vendimmarrje administrative për zbatimin e këtij projekti”.*

- Ankesa e shtetasës Sh.M, prezanton shqetësimin në lidhje me informimin verbal të ankueses dhe disa banorëve të tjerë të zonës së Astirit, nga persona të prezantuar si të punësuar në shtet, por të paidentifikuar, në datat 1 dhe 2 Nëntor 2018, për marrje masash për largim brenda një afati 10 ditor, nga banesat e tyre.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese jemi vënë në dijeni të shkresës nr.1071 prot, datë 14.11.2018, të ARRSH-së, drejtuar Bashkisë Tiranë, ku thuhet shprehimisht se:

“Në kuadër të fillimit të punimeve për zbatimin e projektit:

-Rehabilitim i segmentit rrugor, mbikalimi i “Pallatit me shigjeta” – Rrethrotullimi “Shqiponja” (Lot.1, Lot.2, Lot.3), kërkojmë bashkëpunimin e institucionit tuaj për të bërë të mundur heqjen dhe sistemimin e pemëve të cilat janë pozicionuar në aks dhe në trotualet e rrugës ekzistuese me qëllim mbjelljen e tyre në akse të tjera rrugore.

Për të realizuar këtë bashkëpunim Kontraktorët e të 3 Lot-eve do të jenë në dispozicion, me makineritë e duhura dhe fuqinë punëtore”.

Po kështu konstatohet se, në shkresën të ARRSH-së nr.10172 prot, datë 14.11.2018, drejtuar Bashkisë Tiranë dhe Njësisë Bashkiake nr.6, si dhe Komisarariatit të Policisë Rrugore, thuhet se:

“Autoriteti Rrugor Shqiptar ka lidhur kontratat për zbatimin e punimeve në objektin “Rehabilitim i segmentit rrugor, mbikalimi i “Pallatit me shigjeta” – Rrethrotullimi “Shqiponja”.

Për fillimin e punimeve në këtë objekt dhe vazhdimin normal të tyre kërkojmë nga ana juaj heqjen e të gjithë vendparkimeve të mjeteve përgjatë këtij aksi në krahun e majtë (zonat pranë pallateve).

Gjithashtu, për një menazhim sa më efikas të trafikut të njerëzve në zonat ku projekti do të zhvillohet kërkojmë të kryhet spostimi i terminalit të autobusëve pranë Rrethrotullimit Shqiponja si dhe heqja e parmakëve anësor në trotuarë”.

Më herët me anë të shkresës nr.9765 prot, datë 5.11.2018, Autoriteti Rrugor Shqiptar i është drejtuar IKMT-së, bazuar në ligjin nr.8561 datë 22.12.1999 dhe për realizimin e projektit të Unazës së Madhe Tiranë, segmenti rrugor “Mbikalimi pallati me shigjeta – Rrethrotullimi Shqiponja”, ku thuhet shprehimisht: “...kërkojmë mbështetjen tuaj në bazë të autoritetit që ju jep ligji për lirin e sheshit të ndërtimit nga objektet pa leje”.

Në përgjigjen e dhënë nga ana e IMT në Bashkinë Tiranë në përgjigje të kërkesës sonë për shpjegime lidhur me këtë çështje, në shkresën nr.1062 prot, datë 24.01.2019, ky organ mban qëndrimin se:

“Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Bashkisë Tiranë, nuk ka dijeni zyrtare për miratimin e këtij projekti apo leje zhvillimore në segmentin nga “Mbikalimi i pallatit me shigjeta – rrethrotullimi “Shqiponja””.

Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Bashkisë Tiranë nuk disponon korrespondencë zyrtare me Autoritetin Rrugor shqiptar lidhur me kërkesë për lirim sheshi të ndërtimit në kuadrin e zhvillimit të këtij projekti.

Nga ana e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit nuk është marrë pjesë në ndërhyrjen për prishje të objekteve që pengojnë zhvillimin e këtij projekti”.

IKMT-ja në përgjigje të kërkesës sonë për shpjegime për këtë rast, në shkresën e saj nr.149/1 prot, datë 25.01.2019, ka pohuar ndër të tjera se: “...Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit rezulton e ka verifikuar dhe kontrolluar në terren vetëm në datën 3 Dhjetor 2018 dhe deri më tani nuk janë mbajtur akte administrative për objektet ne poseduara prej shtetasve M. (S)”.

Për aq sa institucioni i Avokatit të Popullit ka arritur të shqyrtojë në lidhje me veprimtarinë e IMT-së, në Bashkinë Tiranë dhe IKMT-së, rezulton se, çdo kërkesë zyrtare e paraqitur ndaj këtyre organeve për lirim të sheshit të ndërtimit, para miratimit të lejes zhvillimore nga ana e KKT-së është e kundërligjshme.

Prishja e disa ndërtimeve/objekteve private të cituara në ankesat e mësipërme, që përfshihen në gjurmën e projektit për të cilin është dhënë leja e zhvillimit e miratuar me vendimin nr.01, datë

20.11.2018, të KKT-së për objektin: “Rehabilitimi i segmentit rrugor “Mbikalimi i pallatit me shigjeta, rrethrotullimi “Shqiponja”, Bashkia Tiranë”, jo vetëm që përbën veprim të kundërligjshëm dhe veprë penale, por evidenton edhe mosndërhyrjen e IMT-së në Bashkisë Tiranë, si dhe të IKMT-së në këto raste. Subjekti që ka kryer këto prishje objektesh dhe që i ka shkaktuar një dëm konkret poseduesve të tyre mbetet ende i paidentifikuar, gjë që kërkon ndjekje të mëtejshme të këtyre rasteve nga ana e organit të Prokurorisë.

Çdo vendimmarrje e organeve të IMT-së në Bashkinë Tiranë dhe IKMT-së, për prishje të ndërtimeve/objekteve në kushtet kur ende nuk kemi një leje ndërtimi të miratuar me vendimin përkatës të KKT-së, me justifikimin e lirimit të sheshit të ndërtimit përbën vendimmarrje në kushtet e paligjshmërisë nga ana e këtyre organeve.

Pozicioni i pretenduar, i tërhequr, i IMT-së në Bashkinë Tiranë dhe IKMT-së, pavarësisht kërkesave të ARRSH-së, i evidentuar nga trajtimi i disa ankesave nga ana jonë nuk justifikon mosveprimin dhe mungesën e sjelljes në vëmendje të faktit të mungesës së lejes së ndërtimit, nga ana e këtyre organeve, që janë organe të specializuara për të kontrolluar në mënyrë të pavarur ligjshmërinë e punimeve të ndërtimit.

Të dy këto organe, IKMT-ja dhe IMT në Bashkinë Tiranë, janë të ngarkuara nga Ligji nr.9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, me përgjegjësinë e kontrollit të territorit dhe zbatimit të ligjshmërisë dhe të standardeve teknike, në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.²⁴

Më konkretisht, IMT në Bashkinë Tiranë, si inspektoriat i mbrojtjes së territorit në njësinë vendore, ka si detyrime ligjore; vendosjen e gjobave në rast shkeljeje të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, daljen me vendim për pezullimin e punimeve/ndërtimeve; daljen me vendim për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm; përgatitjen e kallëzimit penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit; marrjen e vendimit të zhdëmtimit në ngarkim të subjektit kundërvajtës për shpenzimet e prishjes së ndërtimit dhe kthimit të truallit në gjendjen e mëparshme, etj.²⁵

Nga ana tjetër, IKMT ka si detyrime ligjore, ushtrimin e përgjegjësisë të veta në nivel njësie vendore drejtëpërdrejtë dhe pa asnjë kufizim për ndërtimet/punimet që lidhen me çështje, zona ose objekte me rëndësi kombëtare dhe në territor; kontrollin e dispozitave të Ligjit nr.9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, nga IMT në nivel të qeverisjes vendore; ushtrimin e përgjegjësisë të veta të njësisë vendore (kur kjo gjë kërkohet nga vet kjo e fundit, apo kur IMT nuk ka inspektuar territorin dhe nuk është shprehur brenda afateve ligjore për ligjshmërinë ose jo të ndërtimit/punimit), për punime/ndërtime të kundërligjshme në territorin e njësisë vendore që nuk përfshihen në

²⁴ Shih nenin 3, të Ligjit nr.9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar.

²⁵ Shih nenin 5, të Ligjit nr.9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar.

çështje, zona ose objekte me rëndësi kombëtare në territor; ushtrimin e së drejtës së ankimit në gjykatë ndaj lejes së ndërtimit, të miratuar në kundërshtim me ligjin.²⁶

Çdo dëmtim i pronës publike, sikurse ka ndodhur me prishjen e objektit të “Shqiponjës”, në rrethrotullimin e njohur me të njëjtin emër, prishjen e lulishteve publike për krijimin e kantierëve të firmave të ndërtimit të kontraktuara nga ARRSH-ja, pa përmendur këtu edhe heqjen e sinjalistikës rrugore, pemëve dhe trafikndarëseve të rrugës, të gjitha këto pronësi publike, janë bërë në dijeninë e këtyre organeve si rezultat nga korrespondenca me ARRSH (shkresa e datës 14.11.2018). Në këto kushte, këto organe duhej të përgjigjeshin që s’duhej të kryhej asnjë veprim pa dalë akti përkatës dhe jo të mbështesnin për prishje subjekte private.

Nga ana tjetër edhe mosreagimi dhe mosveprimi procedural ligjor, nga ana e IKMT dhe IMT në Bashkinë Tiranë. Kësaj liste i shtohen edhe disa objekte private të prishura dhe të dëmtuara, gjatë kësaj kohe, veprime këto të kryera nga subjekte, të cilat nuk janë të autorizuar nga ligji për kryerjen e një veprimtarie të tillë dhe duke i vendosur ata kështu në kushtet e përgjegjësisë penale. As IKMT dhe as IMT në Bashkinë Tiranë, nuk kanë reaguuar në asnjë prej këtyre rasteve. E gjitha kjo ka ndodhur në rrethana kur, çdo veprim i kundërligjshëm i kryer mbi pasurinë publike dhe atë private, ka gjetur pasqyrim të vazhdueshëm dhe të hollësishëm në media dhe në shtypin e përditshëm. Mosveprimi i dukshëm i këtyre organeve, i vendos personat përgjegjës përfaqësues të tyre, në rrethanat dhe kushtet e përgjegjësisë penale.

Nuk mohohet përgjegjësia e punonjësve dhe drejtuesve të këtyre organeve për të thënë të vërtetën kur kjo gjë ka qënë e dukshme, sikundër nuk duhej të heshte ndaj kërkesave që këtyre organeve i janë drejtuar nga ana e ARRSH-së, kur në kushtet e analizuara më sipër, nga ana e ARRSH-së kërkohej prishja e ndërtimeve, në pronësi shtetërore dhe private.

8. Transparenca e organeve publike të përfshira në këtë proces.

Nocioni i të drejtës së informimit apo siç njihet ndryshe transparenca do të thotë se, çdokush ka të drejtën që t’i bëhet i njohur informacioni i interesit publik, duke u prezantuar si një e drejtë që, jo vetëm ruan vlerat e individëve në një shoqëri demokratike, por edhe shërben si premisë për t’i zhvilluar ato më tej përmes vendosjes së standardeve më të mira.

Transparenca e qeverisjes është një çështje themelore e demokracisë dhe një parakusht për ardhjen sa më afër qytetarëve të saj, të çdo qeverie. Për të bërë Qeverinë të besueshme, individët gëzojnë të drejtën e informimit, apo të njohur ndryshe si, të drejtën e njohjes me dokumentet zyrtare. Por nga ana tjetër, transparenca në procesin e vendimmarrjes është dobiprurëse edhe për vet qeveritë, pasi ajo rrit besimin e individëve në vepritarinë e qeverisë. Kjo lloj marrëdhënie parasheh se e drejta e informimit nuk është thjesht një e drejtë individuale që i shërben vetëm interesave të ngushta të individit, por ajo i shërben edhe vet qeverisësve për krijimin e besimit publik. Informacioni pra, nuk është thjesht një nevojë për njerëzit, ai është pjesë e domosdoshme e një qeverisje të mirë dhe transparente.

²⁶ Shih nenin 9 dhe 9/1, të Ligjit nr.9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar.

Përtej këtij trajtimi teorik konceptual, problematika e analizuar në këtë raport konstaton mungesë transparence në veprimtarinë dhe aktivitetin, apo edhe “pasivitetin”, e organeve publike të përfshira në të gjithë procedurat që lidhen me procesin e hartimit, miratimit dhe zbatimit të projektit, *“Rehabilitim i segmentit rrugor, mbikalimi i “Pallatit me shigjeta” – Rrethrotullimi “Shqiponja” (Lot.1, Lot.2, Lot.3)”*.

Mungesa e transparencës është evidentuar si në marrëdhënien e organeve publike të përfshira në këtë proces, me publikun dhe në veçanti me banorët e zonës së “Astirit”, ku do të zbatohet projekti në fjalë, ashtu edhe me institucionin e Avokatit të Popullit, në kuadër të mosdërgimit të informacioneve të kërkuara prej tij, apo dërgimit të informacioneve të pjesshme dhe jo të plota.

Kjo mungesë transparence është shfaqur që në fillimet e procesit, pasi nga ana e organeve publike të përfshira në të, nuk ka patur një informacion apo njoftim zyrtar të saktë mbi projektin që do të zbatohet në zonën e njohur si zona e “Astirit”, vendimin me të cilin ai ishte finalizuar, koston e tij totale, si edhe koston e planifikuar për shpronësimin e banorëve në bazë të kuadrit ligjor që rregullon procedurat e shpronësimit.

Ka munguar procesi i këshillimit dhe takimit publik, nga ana e autoritetit përgjegjës (ARRSH), për hartimin e dokumentit të planifikimit, i detyrueshëm për t’u zhvilluar ligjërisht përpara çdo vendimmarrje lidhur me dokumentet e planifikimit në nivel qendror dhe me planin e përgjithshëm vendor. Individët apo subjektet përkatëse, banesat apo objektet e të cilëve përfshihen në gjurmën e projektit, *“Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja, Loti 1, Loti 2, Loti 3”*, nuk kanë patur dijeni për projektin përkatës dhe nuk kanë qenë të njoftuar, apo pjesëmarrës në një proces paraprak të diskutimit dhe konsultimit publik të tij.

Kjo mungesë transparence në fazën e miratimit të projekt-idesë “Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja, Loti 1, Loti 2, Loti 3”, evidentohet edhe për faktin se, nuk ka asnjë sqarim apo kopje dokumentacioni zyrtar provues nga ana e ARRSH-së, në përgjigje të informacionit të kërkuar prej nesh, lidhur me konsultimin paraprak dhe informimin e banorëve të zonës së Astirit mbi projektin që do të zbatohet atje.

Projekti përkatës për ndërtimin e segmentit rrugor “Rehabilitimi i segmentit rrugor Mbikalimi Pallati me shigjeta Rrethrotullimi Shqiponja”, është hartuar dhe miratuar në mungesë të transparencës, pa kryer një studim të nevojshëm dhe të kujdesshëm të pronësive që ai prek, si dhe të pasojave komplekse që ai sjell, në shumë aspekte.

Në funksion të zbatimit të projektit *“Rehabilitimi i segmentit Rrugor “Mbikalimi i Pallatit me Shigjeta-Rrethrotullimi Shqiponja, Bashkia Tiranë”*, janë përfshirë në procedurat e shpronësimit të pasurive të paluajtëshme, të ligjshme, individë të caktuar, pa dijeninë e tyre (pra pa u njoftuar zyrtarisht për këtë fakt nga autoriteti përfitues prej procesit të shpronësimit) dhe pa u ndjekur dhe respektuar procedurat dhe afatet që parashikon kuadri ligjor në fuqi, mbi shpronësimin e pasurisë për interes publik.

Ka mungesë transparence nga ana e ALUIZNI-t, në procesin e trajtimit dhe shqyrtimit të vetëdeklarimeve të paraqitura nga individët banorë në zonën e “Astirit”, apo edhe nga subjektet e tjerë për ndërtesat informale të tyre, të ndodhura në këtë zonë.

Që nga fillimi i procesit ka qënë i paqartë dhe jo transparent numri i pasurive, që do t'i nënshtroheshin procesit të shpronësimit, si dhe numri i familjeve dhe shtetasve, të cilët rrezikojnë të mbetën pa strehë. Ky informacion nuk na është dhënë i saktë nga asnjë prej organeve publike veprimtaria e të cilit është analizuar në këtë raport.

Edhe qëndrimi pasiv, i pretenduar, nga ana e IMT në Bashkinë Tiranë, apo edhe IKMT-së, për të gjitha zhvillimet e ndodhura në zonën e Astirit, ku janë cënuar dhe dëmtuar pronësi shtetërore dhe pronësi private, dëshmon mungesë përgjegjësie dhe transparence njëkohësisht nga ana e këtyre organeve që nuk kanë ushtruar kompetencat e tyre ligjore, për të ndaluar veprimet e kundërligjshme, të kryera nga cilido subjekt.

Duke mos përmbushur detyrimin ligjor dhe në mungesë të transparencës së nevojshme ARRSH nuk na ka bërë me dije ndër të tjera edhe datën, në të cilën ka paraqitur kërkesën për miratimin e lejes së ndërtimit nga ana e KKT-së, për zbatimin e projektit, *“Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja, Loti 1, Loti 2, Loti 3”*.

Megjithë informacionin e dërguar, Bashkia Tiranë, nuk ka treguar kapacitetet konkrete që ajo disponon për familjet që rrezikojnë të mbetën pa strehë. Gjithashtu, ky institucion nuk është shprehur rreth garancive reale që do të mund të ofronte programet sociale të strehimit që ofrohen aktualisht nga Bashkia Tiranë.

Mungesa e transparencës për të gjithë procesin e ndjekur në këtë rast, ka qënë një çështje e ngritur edhe në qëndrimin publik të Presidentit të Republikës, pas verifikimeve të kryera mbi projektin e segmentit rrugor *“Mbikalimi i pallatit me shigjeta - rrethrotullimi i Sheshit “Shqiponja”*”.²⁷

Shqetësues mbetet fakti i deklaruar në qëndrimin publik të Presidentit të Republikës, se kërkesave që ai iu ka drejtuar disa institucioneve shtetërore për informacion për çështjet që kanë të bëjnë me detyrat e tyre në lidhje me këtë projekt, nuk i kanë dhënë përgjigje disa prej tyre, edhe pas kalimit të 75 ditëve nga koha e paraqitjes së kërkesës.

Mosdhënia e informacionit të kërkuar apo dërgimi i pjesshëm i tij në institucionin e Avokatit të Popullit, nga ana e institucioneve apo organeve shtetërore të cilëve Avokati i Popullit iu është drejtuar me kërkesa për informacion, për detyrat e tyre në lidhje me këtë projekt, rikonfirmon edhe një herë në këtë këndvështrim se, këtij projekti i ka munguar transparenca në çdo hallkë të tij, në kundërshtim me rendin kushtetues dhe juridik të Republikës së Shqipërisë.

Nëse kjo gjë ndodh në marrëdhënien institucionale të institucionit të Presidentit të Republikës dhe të Avokatit të Popullit me organet dhe institucionet shtetërore që kanë përgjegjësitë e tyre konkrete ligjore për mbarëvajtjen e procesit të hartimit, miratimit dhe zbatimit të projektit, atëherë gjendja paraqitet shumë më e rëndë dhe flagrante në bërjen transparente të procesit, nga ana e këtyre organeve dhe institucioneve shtetërore, ndaj publikut dhe banorëve të zonës së *“Astirit”*.

²⁷ Qëndrimi publik i Presidentit të Republikës së Shqipërisë, i është dërguar për dijeni Avokatit të Popullit, me anë të shkresës përcjellëse nr.131/1 datë 4.02.2019, të Sekretarit të Përgjithshëm, të institucionit të Presidentit të Republikës.

Në këto kushte mungesa e transparencës në këtë proces paraqet një problem strukturor, që nuk duhet anashkaluar apo trajtuar si një çështje dytësore, por duhet të konsiderohet si një çështje shumë thelbësore, pasi lidhet drejtëpërsëdrejti me ligjshmërinë e procesit dhe respektimin e të drejtave themelore të njeriut.

9.Konkluzione përfundimtare

Në përfundim të këtij raporti vijojmë me konkluzionet nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit:

- 1.Situata e zbatimit të projektit “Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi – pallati me shigjeta – rrethrotullimi Shqiponja”, me autoritet zhvillues ARRSH, paraqitet problematike dhe në shkelje flagrante të ligjit, sepse çdo akt i nxjerrë dhe çdo veprim i kryer nga ana e autoriteteve publike të analizuara në këtë raport, ka ndodhur në mungesë të vendimit përkatës të KKT-së, për miratimin e lejes së ndërtimit, për objektin: *“Rehabilitimi i segmentit rrugor “Mbikalimi i pallatit me shigjeta, rrethrotullimi “Shqiponja”, Bashkia Tiranë”*. KKT me vendimin nr.01 datë 20.11.2018 ka miratuar Lejen e Zhvillimit për Objektin, Rehabilitim i Segmentit Rrugor Mbikalimi Pallati me Shigjeta – Rrethrotullimi Shqiponja”, por jo vendimin për miratim leje ndërtimi. Leja e ndërtimit e nxjerrë në kushtet e një akti të ligjshëm dhe të vlefshëm administrativ nga ana e organit kompetent publik (KKT), është i vetmi akt që mundëson dhe lejon njëkohësisht subjektin përfitues të fillojë zbatimin e projektit të miratuar tashmë.
- 2.Procesi nuk ka nisur në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.
- 3.Gjatë gjithë procesit të shqyrtimit të problematikës së krijuar, si pasojë e fillimit të zbatimit faktik të projektit *“Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi – pallati me shigjeta – rrethrotullimi Shqiponja”*, nga ana jonë është evidentuar mungesë transparence dhe mosrealizim të së drejtës për informim, nga ana e organeve publike të përfshira në këtë proces, kundrejt publikut në tërësi dhe në veçanti ndaj komunitetit të banorëve, që do të preket apo është prekur tashmë, nga prishja e disa ndërtimeve private, por edhe nga transformimi i disa pronësive shtetërore në funksion të lehtësimit të veprimtarisë së firmave private, të kontraktuara për zbatim të projektit. Kjo mungesë transparence është evidentuar edhe në informacionet e dërguara Avokatit të Popullit, nga ana e organeve publike të përfshira në process, informacione të cilat kanë qënë jo të plota, jo të sakta, apo edhe të munguara. Mungesa e transparencës për këtë procesi është një çështje e ngritur edhe në qëndrimin publik të Presidentit të Republikës, ku evidentohet fakti se, disa institucioneve shtetërore nuk ia kanë dhënë përgjigje për çështjet që kanë të bëjnë me detyrat e tyre në lidhje me këtë projekt, pavarësisht kërkesave që Kreu i Shtetit iu ka drejtuar për këtë qëllim.
4. Edhe në raport me detyrimin ligjor të organeve publike, përkatësisht ARRSH, ALUIZNI, IMT në Bashkinë Tiranë, IKMT, apo edhe Bashkisë Tiranë, për informimin e Avokatit të Popullit sa i takon informacioneve zyrtare apo të kopjeve të dokumentave publike, konstatohet dhënie e informacioneve në mënyrë të pjesshme dhe jo shterues ndaj kërkesave të parashtruara nga ana jonë. Kjo gjë përbën në vazhdim një shkelje tjetër të rëndë të ligjit nga ana e këtyre organeve publike dhe

- mungesë të luajalitetit institucional në sjelljen dhe marrëdhënien zyrtare me institucionin e Avokatit të Popullit, si një institucion me mandat kushtetues për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut.
5. Në vijim të këtij konkluzioni vihet re edhe pasiviteti i institucioneve shtetërore tek përfshirja për hapat që duhet të ndërmerren në mënyrë të koordinuar, për mbarëvajtjen e procesit.
 6. Nga ana e ARRSH-së, në shkelje të detyrimit ligjor nuk është zhvilluar procesi i detyrueshëm i konsultimit dhe informimit publik me banorët e zonës së Astirit, por edhe me të gjithë aktorët e interesuar, gjatë fazës së hartimit dhe miratimit të projektit “Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi – pallati me shigjeta – rrethrotullimi Shqiponja”.
 7. Procesi korrekt ligjor i miratimit për zbatim, të projektit “Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi – pallati me shigjeta – rrethrotullimi Shqiponja”, mbart një rëndësi të veçantë, pasi në thelb ruan balancën ndërmjet të drejtave dhe interesave të ligjshme të subjekteve private dhe subjekteve publike, të ndërthurura në vendimmarrjet që lidhen me dokumentet e planifikimit, zhvillimit apo kontrollit të zhvillimit të territorit.
 8. Çdo kërkesë e ARRSH-së drejtuar organeve të tjera publike, IMT në Bashkinë Tiranë dhe IKMT-së, për lirim të sheshit të ndërtimit; çdo njoftim për lirim banese si dhe çdo ndërhyrje në ndërtime private për prishjen e tyre apo edhe dëmtimin pjesor nga cilido subjekt qoftë; çdo dëmtim i pronës publike nga cilido subjekt që e ka kryer dhe që e ka lejuar; çdo vendimmarrje për përjashtim nga legalizimi pa u përmbyllur procesi i miratimit të akteve të nevojshme për mundësimin e fillimit të punës për ndërtimin e veprës publike; çdo procedurë shpronësimi e filluar; si dhe çdo veprim tjetër konkludent i kryer në këto rrethana, që ka cënuar të drejtat dhe liritë e ligjshme të banorëve të zonës së Astirit, dhe jo vetëm, është i kundërligjshëm, por dhe i dënueshëm penalisht.
 9. Në këtë kuadër, Avokati i Popullit konstaton se, nga ana e ARRSH-së janë kryer veprime haptazi në kundërshtim me ligjin, të cilat konsistojnë në mospërmbushjen e rregullt të detyrës prej të cilës i është shkaktuar dëm ekonomik shtetit dhe njëkohësisht dëm ekonomik pasuror individëve të prekur nga shembja pa kriter e banesave dhe aktiviteteve private tregtare, që ndodheshin në aksin rrugor që preket nga projektit për ndërtimin e segmentit rrugor “Rehabilitimi i segmentit rrugor Mbikalimi Pallati me Shigjeta - Rrethrotullimi Shqiponja”. Pikërisht në lidhje me këtë fakt Avokati i Popullit konstaton se ndaj përfaqësuesve të ARRSH-së, duhet t’i rekomandojë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, fillimin e hetimeve për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar në nenin 248, të Kodit Penal. Vlen të theksohet se, aktiviteti i kundërligjshëm, i kryer nga subjekti shtetëror ARRSH, evidentohet përmes nxjerrjes së urdhërave që bien në kundërshtim me ligjin, urdhëra të cilët kanë sjellë pasoja të rënda si për shtetin ashtu edhe për individët që janë dëmtuar në pronat e tyre, që kanë qënë të ndërtuara pranë aksit rrugor.
 10. Duke u nisur nga natyra e përgjigjeve të dhëna nga ana e organeve publike, përgjigje këto të paplota dhe kontradiktore, konstatohet një vullnet për të anashkaluar ligjin apo për të kryer punime të kundërligjshme, por edhe për të mënjeluar dhënien e llogarisë apo ushtrimin e kompetencave ligjore. Një fakt i tillë evidentohet veçanërisht në rastin e organeve të IKMT-së dhe IMT-së në Bashkinë Tiranë.

11. Konstatohet se nga veprimet dhe mosveprimet e këtyre dy instancave shtetërore, me mosveprime por dhe në raste të veçanta me veprime, u janë garantuar përfitime materiale ose jomateriale subjekteve përkatëse ndërtuese që kanë kryer punime në këtë objekt dhe njëkohësisht janë dëmtuar haptazi në mënyrë flagrante, interesat e ligjshme të shtetit dhe shtetasve. Si rrjedhojë e punimeve të kryera pa leje ndërtimi dhe pa projekt të miratuar, subjektet përkatëse kanë dëmtuar infrastrukturën rrugore e njëkohësisht edhe pronat e personave që jetojnë pranë aksit rrugor.
12. Prishja e objektit “Shqiponja”, si dhe e lulishteve publike, zënia e hapësirave publike, ngritja e kantierit të ndërtimit nga subjekti “Salillari” pa marrë leje ndërtimi, dëmtimi i plotë i infrastrukturës rrugore në unazën e madhe të Tiranës, në zonën e Astirit, heqja e sinjalistikës, dëmtimi i tapetit të asfaltit, hapja e një grope tek rrethrotullimi ku gjendej objekti “Shqiponja” dhe mundësimi i fillimit të punimeve për zbatimin e projektit për ndërtimin e segmentit rrugor “Rehabilitimi i segmentit rrugor Mbikalimi Pallati me Shigjeta - Rrethrotullimi Shqiponja”, pa leje ndërtimi, ngarkon drejtëpërsëdrejti me përgjegjësi ligjore, penale, institucionet e IKMT-së dhe IMT-së në Bashkinë Tiranë.
13. Prishja e disa ndërtimeve/objekteve private të cituara në ankesat e mësipërme, që përfshihen në gjurmën e projektit për të cilin është dhënë leja e zhvillimit e miratuar me vendimin nr.01, datë 20.11.2018, të KKT-së, për objektin: “Rehabilitimi i segmentit rrugor “Mbikalimi i pallatit me shigjeta, rrethrotullimi “Shqiponja”, Bashkia Tiranë”, jo vetëm që përbën veprim të kundërligjshëm dhe vepër penale, por evidenton edhe mosndërhyrjen e IMT-së në Bashkinë Tiranë, si dhe të IKMT-së, në këto raste. Subjekti që ka kryer këto prishje objektesh dhe që i ka shkaktuar një dëm konkret poseduesve të tyre mbetet ende i paidentifikuar, gjë që kërkon ndjekje të mëtejshme të këtyre rasteve nga ana e organit të Prokurorisë. Çdo vendimmarrje e organeve të IMT-së në Bashkinë Tiranë dhe IKMT-së, për prishje të ndërtimeve/objekteve, në kushtet kur ende nuk kemi një leje ndërtimi të miratuar me vendimin përkatës të KKT-së, me justifikimin e lirit të sheshit të ndërtimit përbën vendimmarrje në kushtet e paligjshmërisë nga ana e këtyre organeve dhe njëkohësisht i ngarkon ato me përgjegjësi penale.
14. Nga tërësia e të dhënave të evidentuara konkludohet se, nga dy organet publike, IKMT dhe IMT në Bashkinë Tiranë, me veprime dhe mosveprime të kryera në kundërshtim me ligjin, në kuadër të mospërbushjes së rregullt të detyrës nga persona që ushtrojnë funksione publike shtetërore, janë cënuar rëndë marrëdhënie juridike që rregullojnë aktivitetin administrativ nga struktura shtetërore, duke i sjellë dëm ekonomik shtetit dhe shtetasve. Veprimet dhe mosveprimet e kryera në këtë kuadër nga IKMT dhe IMT në Bashkinë Tiranë, konsiderohen si shkelje flagrante të ligjit, ndaj edhe këta subjekte duhet të procedohen për vepren penale të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar nga neni 248, i Kodit Penal.
15. Veprimtaria e organit të ALUIZNI-t vazhdon të mbartë mungesën e përgjegjësisë institucionale dhe ligjore për mostrajtimin në afatet ligjore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, të procedurave administrative për shqyrtimin e vetëdeklarimeve për legalizim dhe daljen me një vendim përfundimtar, rast pas rasti. Ky fakt si dhe vendimet e marra për përjashtimin e një sërë ndërtimesh informale të ndodhura në gjurmën e projektit “Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi – pallati me shigjeta – rrethrotullimi Shqiponja”, në mungesë të përfundimit të procesit të vendimmarrjes

- që lejon zbatimin e tij, rëndon pozitën e këtij organi në këtë çështje dhe rrit koston e pasojave që vijnë më pas.
16. Vërehet trajtim me dy standarde i subjekteve në kushte të njëjta dhe për çështje me të njëjtin objekt, në veprimtarinë e ALUIZNI-t gjatë procesit të shqyrtimit të vetëdeklarimeve të ndërtimeve informale, të ndodhura në zonën ku do të zbatohet projekti *“Rehabilitimi i segmentit rrugor “Mbikalimi i pallatit me shigjeta – rrethrotullimi “Shqiponja”*. Në këtë zonë ka ndërtime informale të legalizuara prej vitesh tashmë në bazë të vendimmarrjes të të njëjtit organ, pra të ALUIZNI-t.
 17. Në tërësinë e saj problematika e shqyrtuar nga ana jonë lidhur me zbatimin faktik të projektit, *“Rehabilitimi i segmentit rrugor “Mbikalimi i pallatit me shigjeta – rrethrotullimi “Shqiponja”*, konstaton konfuzion në marrëdhënien institucionale ndërmjet organeve publike të përfshira në të, moskoordinim dhe mungesë koherence në qëndrime që lidhen me pasojat e zbatimit të projektit, si numri i ndërtimeve që preken, numrin e pronave që duhet të shpronësohen, mungesë informacioni dhe mosveprim ndaj ndërhyrjeve të kundërligjshme ndaj pronës private, por edhe asaj shtetërore etj. Duket sikur procesi ka filluar në kushtet de facto pa u konkluduar dhe studjuar mirë në aspektin *de jure*.
 18. Vërehen shkelje ligjore që çenojnë të drejta dhe liri të ligjshme të individit, duke vazhduar kështu gjendja e mosreflektimit ndaj kësaj paligjshmërie dhe duke përkeqësuar situatën juridike të subjekteve që kanë pronësi në zonën ku po zbatohet projekti i sipërcituar.
 19. Pavarësisht faktit se, autoriteti shtetëror zhvillues dhe përgjegjës është ARRSH-ja, vërehet se ka pasivitet nga ana e të gjithë organeve shtetërore të përfshira në këtë çështje. Rrjedhimisht nga ana e Bashkisë Tiranë, për hapat që ata duhej të ndërmerren në mënyrë të koordinuar për mbarëvajtjen e procesit.
 20. Ky segment rrugor prej më shumë se 11 muajsh është jashtë çdo standardi infrastrukturor përkatës. Pavarësisht kësaj nuk ka asnjë përgjegjës për një situatë të tillë, gjë që ka çënuar drejtëpërdrejtë jo vetëm të drejtën themelore të pronës, por edhe cilësinë e jetës së qytetarëve dhe të drejtën e tyre për të pasur dhe përdorur rrugë publike të ndërtuara me standard, dhe të përshtatëshme për plotësimin e nevojave të një jetese normale urbane.
 21. Vetëm pak kohë më parë, nga ana e Avokatit të Popullit është përgatitur dhe dorëzuar në Kuvend, Raporti i Veçantë *“Për problematikat e vërejtura në veprimtarinë e disa organeve të administratës publike, gjatë zbatimit të projektit “Unaza e Jashtme e Tiranës”, Loti III (Sistemimi i shtratit të Lumit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralele, segmenti Materniteti i Ri, Unaza e Jashtme e Tiranës”*. Sikurse në raportin e sipërcituar edhe në këtë raport të veçantë janë konstatuar të njëjtat problematika, gjë që tregon se mosreagimi dhe mosreflektimi në kohë ndaj gjetjeve dhe rekomandimeve tona përkatëse, ka sjellë vazhdimin e një veprimtarie të kundërligjshme dhe në shkelje të të drejtave themelore të njeriut, nga ana e organeve të administratës publike, të përfshira në procesin e zbatimit faktik të projektit, *“Rehabilitimi i segmentit rrugor “Mbikalimi i pallatit me shigjeta – rrethrotullimi “Shqiponja”*.
 22. Gjatë kohës së përgatitjes së këtij raporti, nga konstatimet e drejtëpërdrejta të kryera nga ana jonë, si dhe nga njoftimet e ndryshme të dhëna në media ka rezultuar se, ka patur raste të shkatërrimit të pronës publike, në kundërshtim flagrant me ligjin, nga subjekte të caktuar, të cilët nuk i janë nënshtruar ende përgjegjësisë penale.

23. E gjithë fryma, propaganda dhe komunikimi nga ana e përfaqësuesve të organeve publike të përfshira në këtë proces, të analizuar nga raporti ynë, nuk ka qënë ajo e garantimit dhe respektimit të të drejtave të njeriut, por ndër të tjera ka identifikuar edhe gjuhë urrejtjeje të përdorur ndaj individëve.
24. Problematika e shqyrtuar nga ana jonë lidhur me zbatimin faktik të projektit, *“Rehabilitimi i segmentit rrugor “Mbikalimi i pallatit me shigjeta – rrethrotullimi “Shqiponja”*, konstaton polarizim të çështjes, si dhe krijimin e konflikteve sociale me pasoja serioze, në kuadër të respektimit të të drejtave themelore të njeriut dhe të krijimit dhe ruajtjes së paqes, së nevojshme sociale.
25. Zbatimi i ligjit është detyrë e organeve shtetërore, individëve dhe punonjësve të administratës shtetërore, ndaj edhe për këdo që e shkel atë duhet të merren masa konkrete.
26. Avokati i Popullit në kuadër të mbrojtjes sa më të mirë të të drejtave dhe lirive të ligjshme të individit, si dhe për një mirëadministrim në veprimtarinë e ARRSH-së, ALUIZNI-t, si IMT në Bashkinë Tiranë, IKMT-së, si dhe Bashkisë Tiranë, rishpreh qëndrimin se, projektet madhore janë shumë të rëndësishme për t’u zbatuar, pasi kontribuojnë për zhvillimin e mëtejshëm të vendit. Por është i domosdoshëm respektimi dhe zbatimi rigoroz i kuadrit ligjor në fuqi, i cili ekziston dhe është mjaft i gjerë, si dhe proporcionaliteti lidhur me veprimet që ndërmerren, në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës.

10.Rekomandime:

Në kuadër të konkluzioneve të nxjerra dhe trajtimit analitik tërësor të situatës së krijuar, nga Institucioni i Avokatit të Popullit, paraqiten këto rekomandime konkrete:

- Nevojitet dhe përbën një domosdoshmëri, bashkëpunimi luajal institucional i organeve/institucioneve shtetërore, në të gjitha proceset e realizimit të veprave publike.
- Marrja e masave ligjore nga ana e organeve kompetente, ndaj personave që kanë shkelur dhe shkelin ligjin në trajtimin e këtyre problematikave është një nevojë dhe domosdoshmëri e theksuar me forcë nga ana jonë. Mosndëshkueshmëria, apo mosnxjerrja e përgjegjësive për këto situata, i kthen këto çështje në shembuj të shkeljeve sistematike të të Drejtave të Njeriut, pasi punonjësit e administratës shtetërore, që kanë shkelur si procedurat ligjore të detyrueshme për to, që kanë lejuar prishjen e paligjshme të pronës publike e private, që kanë cënuar interesat e ligjshme të qytetarëve, nuk janë vënë përpara përgjegjësive, as të natyrës administrative, as civile dhe as penale.
- Avokati i Popullit i rekomandon organit të Prokurorisë, fillimin e hetimeve në lidhje me veprimtarinë e ARRSH-së, IKMT-së dhe IMT-së në Bashkinë Tiranë, për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, si dhe për vepra të tjera penale, të cilat do të rezultojnë gjatë hetimit të këtij procesi ndaj subjekteve shtetërore, apo edhe atyre private, referuar shkeljeve ligjore të konstatuara nga hetimi administrativ.
- Avokati i Popullit rekomandon që secili prej institucioneve dhe organeve publike të përmendura në këtë Raport të veçantë, të analizojë me përgjegjësi të gjitha parregullsitë dhe shkeljet ligjore të konstatuara dhe të nisë procedurat e marrjes së masave disiplinore, apo kryerjen e kallëzimeve penale përkatëse, për personat përgjegjës, pas verifikimit dhe dokumentimit të shkeljeve respektive. E drejta e individëve për t’iu drejtuar Gjykatës, nuk

përfshihet përgjegjësinë e organeve dhe institucioneve të tjera shtetërore për t'iu garantuar qytetarëve, mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tyre pasurore dhe një trajtim proporcional rast pas rasti.

- Duke u nisur nga specifikat e konstatuara gjatë hartimit të këtij raporti, por edhe e raporteve të tjera të veçanta të paraqitura tashmë në Kuvendin e Shqipërisë ku trajtohen problematika të ngjashme, gjykojmë se del nevoja e ndryshimit dhe përmirësimit të legjislativës, lidhur me parashikimin e një dëmshpërblimi të arsyeshëm për të gjithë subjektet posedues të objekteve informale që preken nga zbatimi i projekteve për ndërtimin e veprave publike. Në këtë grupim duhet të futen ndërtimet informale për të cilat ka filluar procesi i legalizimit, apo edhe ndërtime të tjera informale, të cilat vërtetohet se janë ekzistuese në kohë, para miratimit dhe zbatimit të projekteve për ndërtimin e veprave publike. Dëmshpërblimi i arsyeshëm duhet të konceptohet në kuadër të një procesi shpronësimi specifik në këto raste. Ky konkluzion kërkon sjelljen në kohorencë të parashikimeve, si dhe ndërmarrjen e iniciativës legjislative për ndryshime në Ligjin nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar dhe për amendime shtaruese, në Ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda BALLANCA